

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5498
E shtunë, 9 qershor 2018
çmimi 0.40 €

EULEX-i, mision të ri në Kosovë deri në vitin 2020



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

THAÇI: SHOIPTARËT JANË NË POZICIONIN MË TË MIRË HISTORIK F. 6

OSBE-JA BËN FUSHATË PËR MBROJTJEN E GAZETARËVE NË KOSOVË F. 3

MAP-i NIS KONSULTIMET PUBLIKE PËR TRI PROJEKTLIGJE F. 5

EKONOMI

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR SIGURIME SOCIALE NË MES TË KOSOVËS DHE ZVICRËS F. 9

LEKAJ FAJËSON ISH-MINISTRIN ZHARKU PËR BORXHIN NDAJ 'BECHTEL ENKA'-S F. 8

KULTURË

QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS I PREMTOHET RITJE E BUXHETIT F. 13

SPORT

KOSOVA, ME 13 GJIMNASTË NË MAQEDONI F. 18

SOKOLI, TRAJNER I LLAPIT F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", ARMEND ZEMAJ

Kuvendi, larg përmbyshjes së obligimeve të ERA-s dhe të MSA-së

- Kuvendi, me kompozimin e tanishëm politik dhe me këtë mazhorancë të brishtë, është larg përmbyshjes së obligimeve që dalin nga ERA dhe zbatimi i MSA-së

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit për Integritet Evropian, Armend Zemaj, ka bërë me dije se gjatë këtij muaji pritet rekomandimi pozitiv i Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se data optimale për lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës në Zonën Shengen është fundi i këtij viti apo fillimi i vitit 2019. Zemaj ka deklaruar se kauzat e shpikura nga opozita e kaluar, lufta e egër për pushtet, krimi i organizuar e korrupsioni si dhe përfshirja e njerëzve me të kaluar kriminale në Qeveri janë

pengesë e përmbyshjes së agjendës evropiane dhe ecjes së Kosovës me hapa të shpejtë. Ai ka vlerësuar se Kuvendi me këtë mazhorancë të brishtë është larg përmbyshjes së obligimeve që dalin nga ERA dhe zbatimi i MSA-së

Haradinaj: Gjendjen në Telekom e kemi trashëguar

Kryeministri Ramush Haradinaj të premtën është paraqitur në interpelancë në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës. Kryeministri ka marrë kritika të shumta

nga deputetët e opozitës rreth gjendjes aktuale në Telekomin e Kosovës, mirëpo Haradinaj ka theksuar se këtë gjendje e ka trashëguar. Ai ka paralajmëruar se do të ndërmerren masa për ta shpëtuar këtë ndërmarrje



PDK-ja bën thirrje për fillimin e reformës zgjedhore

Anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, u ka bërë thirrje të

premtën subjekteve të tjera politike që sa më shpejt të arrijnë një konsensus politik për ta filluar reformën zgjedhore. Në një konferencë për medie ai ka theksuar se kjo parti është e gat-

shme ta japë kontributin e vet në këtë drejtim. Nisjen e reformës zgjedhore e kanë kërkuar edhe zyrtarë të tjerë të lartë të shtetit dhe ekspertë të procesit zgjedhor

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

EULEX-i me mision të ri në Kosovë deri në vitin 2020

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Këshilli Evropian ka vendosur që ta rifokusojë mandatin e misionit të sundimit të ligjit të BE-së në Kosovë, EULEX. Vendimi i së premtes i këtij Këshilli sjell fundin e pjesës ekzekutive në gjyqësor të mandatit të misionit në Kosovë. "Kosova do ta marrë përgjegjësinë për të gjitha hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet e transferuara", thuhet në njoftimin e Këshillit Evropian.

Që nga 14 qershori, misioni i EULEX-it do të përqendrohet në monitorimin e rasteve të zgjedhura dhe gjyqësor në institucionet

penale dhe civile të Kosovës, monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës duke vazhduar mbështetjen operacionale për zbatimin e marrëveshjeve të dialogut të lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. "Misioni do të mbajë disa përgjegjësi të kufizuara ekzekutive në fushat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe mbështetjes për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar, si dhe përgjegjësinë për sigurimin e mirëmbajtjes dhe promovimit të

sigurisë si përgjegjës i dytë i sigurisë", thuhet në njoftim.

Misioni i EULEX-it i themeluar 10 vjet më parë ka pasur dy objektiva operacionale: monitorimin, mentorimin dhe këshillimin, ofrimin e mbështetjes së institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë dhe dialogut Beograd - Prishtinë, si dhe një objektiv ekzekutiv, mbështetjen dhe gjykimin e çështjeve kushtetuese dhe civile dhe ndjekjen penale të rasteve kriminale.

Vendimi i Këshillit Evropian parashikon që mandati i rishikuar të zgjasë deri më 14 qershor 2020.



Gjithashtu, ai cakton një buxhet të kombinuar për operacionet e misionit në Kosovë dhe për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit special prej 169.8 milionë eurosh për dy vjet (15 qershor 2018 - 14 qershor 2020). "Buxheti do t'i mbulojë shpen-

zimet e misionit të EULEX-it në Kosovë prej 83.6 milionë eurosh për zbatimin e mandatit të saj në Kosovë. 86.2 milionë euro do t'i mbështesin dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit special", është theksuar në njoftim e Këshillit Evropian.

Ministrja Hoxha: Të gjeturat e Raportit 2018 po trajtohen me prioritet

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se institucionet e Kosovës janë duke punuar në të gjitha drejtimit për të avancuar në procesin e integritimit evropian, me theks të veçantë në sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe plotësim të standardeve evropiane

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Institucionet e Kosovës janë duke punuar në të gjitha drejtimit për të avancuar në procesin e integritimit evropian. Kështu ka deklaruar të premten ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në tryezën me temë "Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2018". Me këtë rast, ajo ka vënë në pah përparësitë dhe mangësitë e pasqyruara në Raportin për Vëndin të vitit 2018 për të cilat ka thënë se po trajtohen me seriozitet. "Jemi duke punuar në disa drejtimit, me theks të veçantë në sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe plotësim të standardeve evropiane. Siç e dini, Kuvendi i Kosovës më 30 maj 2018 ka miratuar Planin e rishikuar Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për periudhën 2018-2022. Për vitin 2017 ky plan është përmbushur në masën 62%", ka deklaruar Hoxha.

Ajo ka bërë me dije se në fushën e sundimit të ligjit është duke u punuar për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Agjenda për Reforma Evropiane, Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe sfidat e Raportit për Vëndin. "Përqendrimi është në politika e legjislacion, konsolidim të strukturave institucionale dhe përmirësim në zbatimin e legjislacionit. Reforma e Administratës Publike është duke u bërë në koordinim të plotë me BE-në. Fuqizimi i sektorit të sundimit të ligjit do të ketë ndikim pozitiv në përmblylljen e procesit të liberalizimit të vizave, krijimin e një mjedisi më të favorshëm për biznes dhe investime të huaja", ka theksuar ajo.

Po ashtu, Hoxha ka thënë se Qeveria është duke punuar në përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, fuqizimin e strukturave institucionale,



të cilat do ta rrisnin nivelin e bashkëpunimit ndërinstitucional e, bashkë me këtë, edhe nivelin e zbatimit të legjislacionit. "Kosova

është pjesë e shumë iniciativave të ndryshme, si Procesi i Berlinit, Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor që kanë për qëllim

zhvillim e Kosovës dhe rajonit në shumë drejtimit, sidomos në projekte infrastrukturore", është shprehur ministrja Hoxha.

Kroacia mbështet hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në

TIRANË, 8 QERSHOR - Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Fatmir Xhafaj, zhvilloi një vizitë zyrtare në Kroaci, i ftuar nga homologu Davor Bozhinović. Në takim dhe zhvilluar në Zagreb u konfirmua niveli i shkëlqyer i marrëdhënieve mes dy vendeve tona dhe ndihma e pakursyer e Kroacisë për procesin e integritimit të Shqipërisë në BE.

E pranishme në takim për palën

kroate ishte edhe Sekretarja e Shtetit në Ministrinë e Brendshme, Teresa Gras, e cila ka qenë pjesë e kontakteve të vazhdueshme mes dy ministrive për ta thelluar bashkëpunimin në tema të sigurisë, menaxhimit të kufijve dhe migracionit të jashtëligjshëm. Palët konfirmuan bashkëpunimin e gjithanshëm mes dy vendeve partnere dhe mike, të cilat kanë traditë të përbashkët në procesin e

integritimit euro-atlantik. Ministrat e brendshëm diskutuan dhe ranë dakord mbi problematikën e menaxhimit të flukseve të migrantëve, duke theksuar se në kushtet aktuale BE-ja duhet t'i ndihmojë më shumë vendet e rajonit. Ministri Xhafaj bëri një ekspozitë të reformave dhe ecurinë e Shqipërisë në përballje me krimin e organizuar, vetting-un

në Polici, policimin në komunitet, bashkëpunimin policor rajonal dhe ndërkombëtar. Gjatë konferencës së përbashkët për mediet konfirmoi interesin dhe angazhimin për projekte të përbashkëta rajonale për menaxhimin e sezonit turistik, u ra dakord për thellimin e bashkëpunimit mes policive të dy vendeve në kuadër rajonal.



Reforma zgjedhore të kryhet para zgjedhjeve të reja

PDK-ja bën thirrje për fillimin e reformës zgjedhore



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, u ka bërë thirrje të premtën subjekteve të tjera politike që sa më shpejt të arrijnë një konsensus politik për ta filluar reformën zgjedhore. Nëpërmjet një konference për medie ka theksuar se kjo parti është e gatshme ta japë kontributin e vet në këtë drejtim. Nisjen e reformës zgjedhore e kanë kërkuar edhe zyrtarë të tjerë të lartë të shtetit dhe ekspertë të procesit zgjedhor. Ata kanë deklaruar se Kosova nuk duhet të rrezikojë të shkojë në zgjedhje të reja pa e përfunduar këtë reformë

proces i tillë të realizohet sa më parë.

Tahiri ka deklaruar se pjesë e kësaj reforme duhet të jenë jo vetëm subjektet politike, por edhe institucionet e tjera dhe shoqëria civile jo vetëm për ta përmbushur kriterin e gjithëpërfshirjes, por për t'i dhënë hapësirë të mirëfilltë një sektori debatues që në fund të ketë një reformë zgjedhore që është tërësisht funksionale.

Nisjen e reformës zgjedhore më herët e kanë kërkuar edhe zyrtarë të tjerë të lartë të shtetit dhe ekspertë të procesit zgjedhor. Ata kanë deklaruar se Kosova nuk duhet të rrezikojë të shkojë në zgjedhje të reja pa e përfunduar këtë reformë.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se partitë politike duhet të gjejnë vullnet politik për këtë reformë. "Nëse ka vullnet politik nga subjektet politike në pozitë dhe opozitë për të pasur një reformë zgjedhore të mirëfilltë ne do ta japim kontributin tonë. Mirëpo, pa vullnet politik nuk ka reformë zgjedhore. Unë si kryetare e KQZ-së në vazhdimësi u kam bërë thirrje politikanëve dhe institucioneve ta fillojnë reformën zgjedhore, sepse kjo ka qenë një prej rekomandimeve

kryesore nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë. Ka çështje teknike të cilat me shumë pak ndryshime do të rregullohen dhe do ta përmirësonin procesin zgjedhor", ka thënë Daka për gazetë. Ajo ka deklaruar se reforma zgjedhore duhet të bëhet në mes të proceseve zgjedhore dhe jo në prag të tyre.

Edhe koordinatori nacional për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se ky proces kërkon vullnet politik të partive politike. Sipas tij, ky proces kërkon një analizë të thellë profesionale. "Ndërkaq sa i përket reformës zgjedhore, ky proces është iniciuar nga presidenti i Republikës së Kosovës por kjo, para së gjithash, kërkon konsensus dhe vullnet politik nga subjektet politike. Në këtë proces është e domosdoshme një analizë e thellë profesionale duke nxjerrë në pah përparësitë dhe mangësitë e sistemit aktual në mënyrë që në procesin e reformës zgjedhore të kemi qartësi të plotë. Njëkohësisht është tejet e rëndësishme të kemi gjithëpërfshirje dhe analizë të modeleve të sprovuara, gjithnjë duke u përshtatur me kontekstin", ka thënë Tahiri.

Kurse ish-anëtari i KQZ-së nga

LDK-ja, Florian Dushi, ka thënë se ndonëse një reformë e tillë është e nevojshme tani për tani nuk ka ndonjë iniciativë në këtë drejtim. "Nëse e kemi parasysh faktin se Kosova tashmë ka humbur ritmin e ciklit të paraparë kushtetues të mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta (sepse tri palë zgjedhje pas shpalljes së pavarësisë ishin zgjedhje të jashtëzakonshme), problemet me të cilat ballafaqohet qeveria aktuale, e cila me shumë vështirësi edhe ka siguruar mbështetje në Kuvendin e Kosovës që në momentin e formimit të saj, atëherë me lehtësi mund të konkludojmë se, nëse së shpejti nuk do të kemi një iniciativë serioze rreth reformës zgjedhore, vendi ynë sërish mund të 'zihet' në befasi nga zgjedhje të reja e të jashtëzakonshme, por me sistem të vjetër zgjedhor", ka thënë Dushi.

Procesi i reformës zgjedhore ka filluar pas zgjedhjeve nacionale të vitit 2010 dhe ende nuk ka përfunduar. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në vitin 2016 kishte nisur takimet me partitë politike dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për reformën zgjedhore, por edhe kjo nismë ka mbetur pezull.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka ftuar subjektet politike që sa më shpejt të arrijnë një konsensus dhe të fillohet me reformën zgjedhore. Në një konferencë me gazetarë në selinë e PDK-së, Tahiri ka pohuar se e gjithë platforma e propozuar nga Kadri Veseli, me pesë çështje të interesit nacional, ku përfshihet edhe konsensusi për reformë zgjedhore, duhet të ecë përpara. "Sa i përket reformës zgjedhore, në esencën e saj, Partia Demokratike e Kosovës e sheh si kusht themelor dhe të domosdoshëm garantimin e një procesi

zgjedhor të drejtë, korrekt e të paanshëm. Ne të gjithë marrim pjesë në jetën politike ku pushteti sovran i popullit legjitimon me votë përfaqësuesit që bartin atë pushtet legjitim, në mënyrë që t'i realizojnë aspiratat dhe kushtet e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë. Prandaj, e konsiderojmë jashtëzakonisht të rëndësishme që rezultati i kësaj reforme të jetë një sistem elektoral që siguron qytetarët me të drejtë vote të vendit tonë, se vullneti i tyre ka shkuar në vend", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se Partia Demokratike e Kosovës edhe në rrafshin politik, edhe në rrafshin profesional përmes ekspertëve, është e gatshme për ta dhënë kontributin maksimal, që një

OSBE-ja bën fushatë për mbrojtjen e gazetarëve në Kosovë

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë po vazhdon fushatën për vetëdijesimin e publikut rreth sigurisë së gazetarëve në mbarë Kosovën. Në një komunikate për media, OSBE-ja ka theksuar se fushata

adreson sfidat e vazhdueshme me të cilat përballen gazetarët gjatë punës së tyre dhe ndikimin e këtyre sfidave në punën e tyre.

Fushata e OSBE-së thekson edhe rëndësinë e gjetjes së autorëve të çdo forme kërcënimi ose sulmi ndaj gazetarëve, në

mënyrë që sulmet e tilla të parandalohen në të ardhmen. "Gazetarët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve specifike të frikësimit, kërcënimeve apo sulmeve fizike për shkak të punës së tyre. Është e rëndësishme që secili pjesëtar i shoqërisë ta kuptojë nevojën për t'i mbrojtur

gazetarët dhe për të kontribuar për një mjedis që respekton lirinë e fjalës dhe lirinë e medias", citohet të ketë thënë shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu. Vetëm në vitin 2017 janë raportuar gjithsej 28 kërcënime ose sulme fizike ndaj gazetarëve.



Flet për "Epokën e re", Armend Zemaj

Kuvendi, larg përmbushjes së obligimeve të ERA-s dhe MSA-së

- Kuvendi, me kompozimin e tanishëm politik dhe me këtë mazhorancë të brishtë, është larg përmbushjes së obligimeve që dalin nga ERA dhe zbatimi i MSA-së

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit për Integritet Evropian, Armend Zemaj, ka bërë me dije se gjatë këtij muaji pritet rekomandimi pozitiv i Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se data optimale për lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës në Zonën Shengen është fundi i këtij viti apo fillimi i vitit 2019. Zemaj ka deklaruar se kauzat e shpikura nga opozita e kaluar, lufta e egër për pushtet, krimi i organizuar e korrupsioni si dhe përfshirja e njerëzve me të kaluar kriminale në Qeveri janë pengesë e përmbushjes së agjendës evropiane dhe ecjes së Kosovës me hapa të shpejtë. Ai ka vlerësuar se Kuvendi me këtë mazhorancë të brishtë është larg përmbushjes së obligimeve që dalin nga ERA dhe zbatimi i MSA-së

Ai ka mirëpritur lobimin e delegacionit të Kosovës tek vendet anëtare të BE-së për vizat por, sipas Zemajt, ata që kanë shkuar për të lobuar duhet të jenë të pranueshëm dhe me njohuri të avancuara në raportet ndërkombëtare. "Duhet të jemi të pranishëm në skenën evropiane, sidomos në raport me vendet mike që e kanë mbështetur Kosovën në rrugëtimin e saj në krye me ShBA-të. Por, vizitat e tilla duhet të kenë gjithmonë strategji të qartë, format dhe impakt të ndërsjellë në zhvillimin e diplomacisë parlamentare, ndërsa në rastin e tillë lobimi për vizat dhe integritet evropiane duhet të jetë në format të individëve të pranueshëm dhe me njohuri të avancuara në raportet ndërkombëtare", është shprehur ai.

Zemaj ka thënë se kauzat e shpikura nga opozita e kaluar, lufta e egër për pushtet, krimi i organizuar e korrupsioni dhe tani logjika se si me lehtësi kjo qeveri mban në gjirin e saj njerëz me të kaluar kriminale dhe me aktakuza janë pengesë e përmbushjes së agjendës evropiane dhe ecjes së Kosovës me hapa të shpejtë. Në këtë kontekst, ai ka vlerësuar se Kuvendi me këtë mazhorancë të brishtë është larg përmbushjes së obligimeve që dalin nga ERA dhe zbatimi i MSA-së. "Komisioni ka shtuar angazhimin në kërkesat për raportim dhe mbikëqyrje të ministrive dhe dikastereve të tjera që kanë obligime strikte në avancimin dhe përmbush-



jen e obligimeve qofshin ato kontraktuale dhe nga kërkesat e BE-së, duke pasur për fokus edhe legjislacionin tonë që të jetë në harmoni me Acquis communautaire. Pjesa tjetër e punës ndërlidhet edhe me pjesën tjetër që komisioni mbulon angazhimin e Kuvendit në organizatat rajonale dhe institucioneve të BE-së në përafrimin e Kosovës me BE-në dhe institucionet e tjera ndërkombëtare", ka theksuar Zemaj.

"Epoka e re: Z. Zemaj, këtë muaj pritet të merret vendimi për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. Pritjet e juaja si komision janë se ky vendim do të jetë pozitiv, pra Kosovës do t'i rekomandohet heqja e vizave?"

Zemaj: Dëshira jonë është të marrim një përgjigje pozitive. Kjo është pritje e gjatë e jona dhe qytetarëve të Republikës së

Kosovës. Me gjithë plotësimin e shumicës së kriterëve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian për Kosovën, shqetësimi ynë është se raporti për vendin i BE-së konsideron se Kosova ndodhet në përgjithësi me një progres të kufizuar. Kjo është pjesa shqetësuese dhe kërkesa jonë e vazhdueshme që Qeveria t'i ushtrojë kompetencat e veta dhe të ketë vullnet politik për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë. Shpresa mbetet te vullneti pozitiv i vendeve anëtare që ta marrim datën e shumëpritur dhe shumëkërkuar nga të gjithë ne.

"Epoka e re": Në rast se ndodh një gjë e tillë, kur qytetarët e vendit do të mund të lëvizin pa viza në Zonën Shengen?"

Zemaj: Ne tani jemi në pritje të datës, por duke marrë për bazë praktikën e vendeve të tjera të

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Zëvendëskryetari i parë i Komisionit për Integritet Evropian, Armend Zemaj, ka thënë të premtën se janë në pritje të rekomandimit pozitiv nga Bashkimi Evropian sa i përket liberalizimit të vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se duke marrë për bazë praktikën e vendeve të tjera të cilat kanë kaluar këtë proces, data optimale për lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës në Zonën Shengen mund të jetë fundi i këtij viti apo fillimi i vitit 2019. "Dëshira jonë është të marrim një përgjigje pozitive. Kjo është pritje e gjatë e jona dhe qytetarëve të Republikës së

Kosovës. Me gjithë plotësimin e shumicës së kriterëve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian për Kosovën, shqetësimi ynë është se raporti për vendin i BE-së konsideron se Kosova ndodhet në përgjithësi me një progres të kufizuar. Kjo është pjesa shqetësuese dhe kërkesa jonë e vazhdueshme që Qeveria t'i ushtrojë kompetencat e veta dhe të ketë vullnet politik për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë. Shpresa mbetet te vullneti pozitiv i vendeve anëtare që ta marrim datën e shumëpritur dhe shumëkërkuar nga të gjithë ne. Duke marrë për bazë praktikën e vendeve të tjera të cilat kanë kaluar këtë proces, data optimale mund të jetë fundi i këtij viti apo fillimiviti 2019", ka deklaruar Zemaj.



cilat kanë kaluar këtë proces, eventualisht duke shpresuar në përgjigjen pozitive, data optimale mund të jetë fundi i këtij viti apo fillimi i vitit 2019.

"Epoka e re": Para dy ditësh një delegacion i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryeparlamentari, ka filluar lobimin për liberalizimin. A besoni se do të ketë sukses?

Zemaj: Duhet të jemi të pranishëm në skenën evropiane, sidomos në raport me vendet mike që e kanë mbështetur Kosovën në rrugëtimin e saj në krye me ShBA-në. Por, vizitat e tilla duhet të kenë gjithmonë strategji të qartë, format dhe impakt të ndërsjellë për zhvillimin e diplomacisë parlamentare, ndërsa në rastin e tillë lobimi për vizat dhe integrimet evropiane duhet të jenë në format të individëve të pranueshëm dhe me njohuri të avancuara në raportet ndërkombëtare.

"Epoka e re": Në përgjithësi sa ka avancuar agenda evropiane e Kosovës dhe Kuvendi sa ka arritur t'i përmbushë obligimet në kuadër të kësaj agjende?

Zemaj: Janë dy çështje të ndara, agenda evropiane ka pasur avancimet dhe ngecjet e saj edhe si proces, edhe si kërkesë e BE-së, me sfidat të cilat ka kaluar vendi, por edhe me keqeverisjen e cila ka ngadalësuar këtë proces. Kauzat e shpikura nga opozita e kaluar, lufta e egër për pushtet, krimi i organizuar e korrupsioni dhe tani logjika se si me lehtësi kjo qeveri mban në gjirin e saj njerëz me të kaluar kriminale dhe me aktakuza është pengesë e përmbushjes së agjendës evropiane dhe ecjes së Kosovës me hapa të shpejtë. Sigurisht Kuvendi ka rol kyç dhe specifik, por me kompozimin e tanishëm politik dhe me këtë mazhorancë të brishtë është larg përmbushjes

së obligimeve që dalin nga ERA dhe zbatimi i MSA-së.

"Epoka e re": Cilat do të jenë prioritetet e Komisionit për Integritet, Kuvendit në përgjithësi për t'u përafuar me Bashkimin Evropian?

Zemaj: Komisioni ka shtuar angazhimin në kërkesat për raportim dhe mbikëqyrje të ministrive dhe dikastereve të tjera që kanë obligime strikte për avancimin dhe përmbushjen e obligimeve qofshin ato kontraktuale dhe nga kërkesat e BE-së, duke pasur për fokus edhe legjislacionin tonë që të jetë në harmoni me Acquis communautaire. Pjesa tjetër e punës ndërlidhet edhe me pjesën tjetër që Komisioni mbulon në angazhimin e Kuvendit në organizatat rajonale dhe institucioneve të BE-së në përaftrimin e Kosovës me BE-në dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

MAP-i nis konsultimet publike për tri projektligje

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Ministria e Administratës Publike (MAP) ka filluar të premtën fushatën e informimit dhe konsultimit të publikut për pakon legislative të tri projektligjeve të administratës: Projektligjin për Administratën Shtetërore, Projektligjin për Zyrarët Publikë si dhe Projektligjin për Pagat.

Ministri Administratës Publike, Mahir Jaghillar, për këtë fushatë e cila do të zgjasë 15 ditë pune, është shprehur se synon përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile për t'i njoftuar me ndryshimet që sjellin këto ligje. Sipas Jaghillarit, sot fillon një fazë qenësore në procesin vendimmarrës në miratimin e pakos për reforma publike. "Këto tri ligje po bëhen që administrata publike të jetë në shërbim më të mirë ndaj qytetarëve. Në këtë aspekt më lejoni të nënvizoj disa segmente kryesore për projektligjet. Projektligji për administratën shtetërore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionim e institucioneve të administratës publike dhe agjencive të pavarura të themeluara nga kuvendi, qëllimi i projektligjit është krijimi i kuadrit koherent ligjor për krijimin, drejtimin, mbarëvajtjen, përgjegjshmërinë dhe performancën e tyre. Ndërsa projektligji për zyrarët publikë ka për qëllim krijimin e kornizës ligjore për punësim të zyrarëve publikë në institucione të bazuar në merita, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri", u shpreh ministri Jaghillar.

Koordinatori Shtetëror për Reforma, Besnik Tahiri, ka thënë se konsultimi publik për pakon e ligjeve të administratës shtetërore është korniza, themeli dhe shtylla të një shteti funksional evropian. "Proces

konsultativ për këtë pako të ligjeve ka qenë i vazhdueshëm me ministrinë, aktorët e shoqërisë civile, përfaqësues të sindikatave dhe zyrarët në të gjitha nivelet dhe se kjo pako e ligjeve po vjen në një moment të rëndësishëm në Kosovë. Kur flasim për reforma, flasim për rrugëtimin evropian. Ne po e rregullojmë në esencë raportin e institucioneve shtetërore, po e rregullojmë shërbimin civil - zyrarin publik dhe në bazë meritore po i vëmë koeficientin zyrtar shtetëror", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se deri më tani ka qenë një situatë jo e mirë. "Ka qenë një disproporcion i madh i pagave, një numër i madh i koeficienteve dhe pozitive, mirëpo me këtë ligj do të formalizohet një proces i barabartë në të gjitha nivelet shtetërore. Pra, parimi është i thjeshtë, punën e njëjtë - pagën e njëjtë", ka deklaruar Tahiri.

Tahiri për këtë proces ka dhënë edhe disa porosi. "Porositë e mia në hapje të këtij procesi janë: e para, është për shoqërinë civile, duke u bërë thirrje ta shikojnë me kujdes, para se të adresojnë kritikën t'i japin të gjitha komentet dhe kontributin në këtë proces. E dyta, këto tri ligje nuk janë ligje që rregullojnë administratën e një koalicioni qeverisës, por administratën shtetërore në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe agjendës integruese. Me këtë rast ftoj të gjitha partitë parlamentare që t'i konsultojnë këto ligje para se ligjet të shkojnë në parlament, në mënyrë që të sigurojmë konsensus të gjerë politik. E treta, roli i medieve është i rëndësishëm dhe që procesin ta përcjellin sa më afër, duke informuar qytetarët, njëherësh promovuar proceset reformuese", ka thënë Tahiri.



Mbahet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Lidhja Shqiptare e Prizrenit"

Thaçi: Shqiptarët janë në pozicionin më të mirë historik

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka theksuar se në 140-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit shoqëria shqiptare është në pozicionin më të mirë historik. Ai ka thënë se Shqipëria është vend anëtar i NATO-s, në rrugë drejt anëtarësimit në BE, kurse shteti i Kosovës është konsoliduar si shtet si në rrafshin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Lidhja Shqiptare e Prizrenit". Presidenti Thaçi është shprehur i nderuar që ka marrë pjesë në hapjen e punimeve të kësaj konference, 140 vjet pas Lidhjes Shqiptare e Prizrenit, të organizuar nga dy akademitë e shkencave, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë.

I pari i vendit theksoi se në 140-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit shoqëria shqiptare është në pozicionin më të mirë historik. Presidenti Thaçi pohoi se Shqipëria është vend anëtar i NATO-s, në rrugë drejt anëtarësimit në BE, kurse shteti i Kosovës është konsoliduar si shtet si në rrafshin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar dhe tani në fokus ka objektivin e tretë, atë të integriteteve euroatlantike.

"Është koha që shkencëtarët ta studiojnë dhe vlerësojnë jo vetëm rilindjen tonë kombëtare, Lidhjen e Prizrenit, por të gjitha periudhat e historisë shqiptare me objektivitet shkencor të dijes bashkëkohore. Historia, e vërteta është një, e pakorrigjueshme, ndërsa historiografia duhet të shkruhet në përputhje me të vërtetën dhe të korrigjohet nga ndikimi ideologjik, censura dhe format e tjera", u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se dy akademitë tona, 140 vjet pas Lidhjes së Prizrenit, mund të veprojnë në kushte shumë më të volitshme se në të gjitha kohët deri më tash, sepse më nuk ka as diktaturë, as robëri. "Lidhja e Prizrenit ishte veprim dhe rezultat i situatës së re gjeopolitike që solli kriza lindore. Me vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, pas tërheqjes së Perandorisë Osmane nga Ballkani, shumica e trojeve shqiptare, edhe ashtu të ndara në disa vilajete, u jepeshin

shteteve fqinje. Ndërsa në Kongresin e Berlinit, ku Fuqitë e Mëdha vendosnin pa e përfillur vullnetin e popullit shqiptar, ishte thelluar padrejtësia historike, me marrjen e vendimeve për implementimin e këtij copëtimi. Kështu, shqiptarët kërcënoheshin nga tri rreziqe: shpërbërja territoriale, asimilimi dhe zhdukja fizike", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se në këtë situatë të re shqiptarët nuk ndenjnë duarkryq.

I pari i vendit theksoi se më 10 qershor 1878 përfaqësuesit e të gjitha viseve shqiptare në Prizren krijuan organizatën me karakter politik, ushtarak dhe ekzekutiv, që do t'i kundërvuhej synimit të copëtimit të tokave shqiptare me të gjitha mjetet. "Lidhja e Prizrenit është organizata më e rëndësishme politike dhe ushtarake e popullit shqiptar, e krijuar katër shekuj pas qëndresës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Kryengritjet e shumta, memorandumet drejtuar kancelarive të Fuqive të Mëdha, protestat dhe forma të tjera të qëndresës e karakterizuan periudhën e Lidhjes së Prizrenit", ka thënë presidenti Thaçi.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, sipas presidentit Thaçi, në rrafshin e brendshëm është produkt i lëvizjes kulturore, i Rilindjes Kombëtare. Derisa në Jug të Shqipërisë po krijohet ndërgjegjja kulturore, pra nacionalizmi kulturor, presidenti Thaçi theksoi se në viset e veriut ballafaqimi i përditshëm me aspiratat aneksuese të fqinjëve po krijonte vetëdijen shtetërore, nacionalizmin politik. "Rilindësit shqiptarë ishin personalitete që me idealizëm të rrallë, në kushtet kur në tokat shqiptare nuk kishte asnjë institucion kulturor dhe arsimor, vunë themelet e ndërgjegjes kombëtare, duke tejkaluar ndarjet krahinore dhe fetare",

Vizioni properëndimor i UÇK-së gjeti mbështetjen te bota demokratike

Kreu i shtetit, Hashim Thaçi, ka thënë se pas një shekulli sundim nga të gjitha regjimet dhe administrimet e Beogradit, Kosova më në fund arriti ta krijojë organizatën më të rëndësishme politike dhe ushtarake në historinë e kombit shqiptar, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. "Vizioni i saj properëndimor bëri që të gjejë mbështetje te bota demokratike, tek ShBA-ja, shtetet e BE-së dhe NATO. Për herë të parë në histori shqiptarët qenë pjesëmarrës, folën dhe vendosën në interesin e tyre në Konferencën Ndërkombëtare në Rambuje dhe Paris më 1999", shtoi presidenti Thaçi.

pohoi presidenti Thaçi.

Ai shtoi se Rilindja Kombëtare krijoi vetëdijen për identitetin e kombëtar shqiptar, të bazuar mbi vlerat e përbashkëta të gjuhës, kulturës, traditave dhe të njësisë territoriale. "Për këtë kontribut iluminist dhe intelektual, si gjithmonë, edhe sot i jemi mirënjohës asaj plejade mendjendritur që punoi me aq përkushtim patriotik. U jemi mirënjohës shumë e shumë penave të tjera që kultivuan letërsinë, hartuan traktatet politike, zhvilluan gjuhën shqipe, themeluan klube e revista kulturore, përqafuan alfabetin latin dhe vlerat e qytetërimit evropian", ka thënë presidenti Thaçi.

Krahas figurave kulturore, ai theksoi se nuk ka si të mos i vlerësojmë lart personalitetet qendrore të Lidhjes së Prizrenit, ideologun e saj Abdyl Frashërin, kryetarin e Qeverisë së Përkohshme, Ymer Prizrenin, komandantin e Ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit, Sulejman Vokshin dhe shumë e shumë patriotë të tjerë, që me mençuri dhe vizion reagues përballë rreziqeve që cenonin ekzistencën fizike të popullit tonë. "Me veprimet e veta, Lidhja Shqiptare e Prizrenit tërhoqi vëmendjen e diplo-

matëve dhe konsujve të huaj, duke dëshmuar se shqiptarët po mobilizonin forca dhe nuk lejonin implementimin e marrëveshjeve të padrejta ndërkombëtare që copëtonin hapësirat e tyre etnike. Rilindja Kombëtare dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit e shekullit 19, rrumbullakoi vetëm pjesërisht idealet e shqiptarëve në fillim të shekullit 20, me krijimin e shtetit të pavarur të Shqipërisë, më 28 nëntor 1912", ka thënë presidenti Thaçi.

Në zhvillimet dramatike gjatë Luftës së Parë Ballkanike, presidenti Thaçi ka thënë se ndodhi paradoksi historik dhe territori shqiptar që më së shumti kishte kontribuar për bërjen e Shqipërisë, Kosova, por edhe viset e tjera shqiptare, mbetën padrejtësisht jashtë Shqipërisë. "Me gjithë fatin tragjik, Kosova e ruajti esencën dhe bërthamën e saj kombëtare. Gratë dhe burrat që u angazhuan në procesin e pavarësisë së Shqipërisë vazhduan me të njëjtin idealizëm rezistencën për çlirimin e Kosovës, duke dhënë jetën për ëndrën dhe idealin e lirisë si Hasan Prishtina, Shotë Galica, Azem Bejta dhe të tjerë", u shpreh presidenti Thaçi.



Bajram Rexhepi, pas vdekjes, nderohet me Medaljen Presidenciale

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar me Medaljen Presidenciale Jubilarë të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë, pas vdekjes, ish-kryeministrin e Kosovës dhe ish-kryetarin e Mitrovicës, Bajram Rexhepin, njeriun human që me përkushtimin e tij shëroi shumë

plagë lufte. "Bajram Rexhepi ishte kryeministri i parë i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës. Ai dha kontribut të çmuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, si dhe ishte gjithmonë në shërbim të vendit dhe të qytetarëve", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kuvendi i Kosovës ka vazhduar seancën e radhës

Haradinaj: Gjendjen në Telekom e kemi trashëguar

Kryeministri Ramush Haradinaj të premten është paraqitur në interpelancë në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës. Kryeministri ka marrë kritika të shumta nga deputetët e opozitës rreth gjendjes aktuale në Telekomin e Kosovës, mirëpo Haradinaj ka theksuar se këtë gjendje e ka trashëguar. Ai ka paralajmëruar se do të ndërmerren masa për ta shpëtuar këtë ndërmarrje

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka vazhduar të premten seancën plenare të radhës, ku kryeministri Ramush Haradinaj ishte i thirrur në tri interpelanca: në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës; në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës; në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikallo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.

Kryeministri Ramush Haradinaj gjatë interpelancës rreth korrupsionit në institucione dhe zyrtarët e lartë të Kosovës ka shpalosur raportin i cili ka përmbledhur të gjitha të dhënat në lidhje me sundimin e ligjit dhe rendit. Ai ka thënë se gjendja me sundimin e ligjit nuk është e kënaqshme, mirëpo janë duke punuar në këtë drejtim. "Fokusi ynë ka qenë ndihma për institucionet e rendit dhe ligjit që ta ushtrojnë punën e tyre të pavarur dhe të pandikuar. Nuk po them për t'u mburrë tash, por në krahasim me qysh ka qenë, sot është një Kosovë tjetër", ka thënë ai. Sipas Haradinajt, në Kosovë që nga paslufta gjendja është më e mira.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, partia e së cilës ka iniciuar këtë interpelancë, i ka rekomanduar

kryeministrit Haradinaj të dorëhiqet nëse nuk mund ta frenojë veten dhe qeverinë që mos të ndërhyjnë në çështje që i përkasin sistemit të drejtësisë. "Nëse nuk mund ta frenosh veten dhe qeverinë për vendimet dhe çështjet që iu përkasin institucioneve të drejtësisë, vendimin më të mirë që mund ta marrësh për këtë vend dhe qytetarët e këtij vendi është të dorëhiqesh", ka thënë Pacolli.

Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se një dekadë pas shpalljes së pavarësisë së saj Kosova vazhdon të ketë vështirësi që të bëhet shtet funksional. "Krimi dhe korrupsioni janë dhe mbeten kërcënime e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit. Zhvillimet e Kosovës si një shtet funksional vazhdojnë të jenë të brishta, sidomos pas ardhjes së kësaj qeverie të koalicionit. Raporti për vendin konsideron se Kosova mbetet në fazën fillestare ende në luftën kundër korrupsionit me një progres të kufizuar", ka thënë Zemaj.

Deputeti i PDK-së, Hajdar Beqa, ka thënë se duhet të shikohet nëse institucionet e ndërtuara gjyqësore dhe prokuroriale janë duke arritur ta kryejnë punën e tyre në luftimin e korrupsionit. Ndërkaq, në interpelancën e thirrur nga grupet parlamentare, LV-së dhe LDK-së, lidhur me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës, kryeministri Ramush Haradinaj ka shpjeguar gjendjen në të cilën e ka gjetur Telekomin. "Gjendjen



financiare çfarë e kemi sot, e kemi trashëguar. Borxhi total i kompanisë është 60 milionë euro nga të dhënat që i posedojmë ne nëpër vite dhe ka vazhduar kështu", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, gjendjen e tillë e ka shkaktuar menaxhimi i dobët, mungesa e një plani të biznesit, pezullimi i investimeve, kontratat e dëmshme, proceset e dëmshme, arbitrazhet e humbura etj. "Pas identifikimit të gjendjes ne e kemi skanuar gjendjen. Kemi kërkuar ndërprerjen e kontratave komerciale që lejojnë edhe më tutje funksionimin", është shprehur Haradinaj. Sipas tij, me bordin e drejtorëve ekzistues kanë kërkuar të themelohet një grup që i vlerëson kontratat e qirave, kanë kërkuar të përgatitet një plan i cili buron prej tyre, në mënyrë që ta shmangin falimentimin e ndërmarrjes.

Kryeministri ka folur edhe për uljen e pagave të punëtorëve të Telekomit. "Edhe ulja e pagave në

këtë rast është logjike, se paga mesatare është mbi mesataren. Nëse nuk ndërmerret një zinxhir i masave, ulja e pagave, ndërprerja e kontratave të dëmshme, kompania është në gjendje të vështirë", ka thënë Haradinaj. Kurse Albin Kurti në emër të parashtresit të interpelancës ka thënë se me situatën e krijuar në Telekom nuk ka dështuar ky i fundit, por shteti. "Sot telekomi e ka të vështirë t'i paguajë pagat. Askund në botë ndërmarrjet e telekomunikimit nuk falimentojnë. Kemi informacionin se Devollët kanë një partner në Qipro dhe dihet se ata nuk bëjnë investime në 'Z mobile'. Mësova se Devolli nuk ka kompani në Kosovë, se e ka bartur kapitalin në Maltë. Po fshihet atje, se po e vëren rrezikun për ndryshimet që po ndodhin në Kosovë. Nuk ka dështuar Telekomin, por shteti. Nuk po falimenton Telekomin, por shteti", ka thënë Kurti.

Lumir Abdixhiku, parashtres i

interpelancës në emër të LDK-së, ka bërë krahasimin mes numrit të punëtorëve mes Telekomit dhe IPKO-s. Në PTK, sipas tij, kishte punësim militant. "Kur ka rënie drastike si kjo duhet për t'u bërë shkurtimi i shpenzimeve, por kjo nuk ka ndodhur. Në PTK numri i të punësuarve është rritur. Ka pasur rritje edhe të pagave. Paga mesatare në PTK është 1 000 euro", ka thënë Abdixhiku.

Telekomi, sipas tij, i ka 2 300 punëtorë me mbi 50 për qind të tregut. Kurse IPKO ka 40 për qind të tregut dhe i ka 300 punëtorë. "Krahasoni, bëhet fjalë për treg për afërsisht të njëjtë", ka deklaruar Abdixhiku. Ai ka thënë se PDK-ja ka pasur kandidat për deputet një kryeshef të Valës i cili, sipas tij, e ka sjellë Telekomin në këtë situatë me bashkëpartiakët e tij. Pas kësaj deklarate ka reaguar menjëherë deputeti i PDK-së, Hajdar Beqa, duke thënë se asnjë kryeshef nuk ka qenë kandidat për deputet.



LDK-ja akuzon presidentin për bllokim të KOZ-së

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Subjekti më i madh opozitar në Kosovë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka ngritur shqetësimet lidhur me mosëmërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KOZ). Në një konferencë për media të premten, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se mosëmërimi i anëtarëve të KOZ-së nga presidenti Hashim Thaçi

është krijuar një precedent i rrezikshëm për sistemin zgjedhor dhe për demokracinë në vend. "Presidenti e ka bllokuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga data 27 mars 2018. Është hera e parë që kjo ndodh që nga themelimi i këtij institucioni pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Presidenti nuk është duke e kryer detyrën e vet kushtetuese sipas nenit 84, pika 2 e Kushtetutës, edhe

pse subjektet politike i kanë dërguar propozimet e tyre", ka thënë Hoti. Ai ka deklaruar se partia e tij kërkon nga presidenti Thaçi që ta kryejë obligimin e vet kushtetues. "Mosfunksionalizimi i KOZ-së për dy muaj ka ndikuar negativisht në punën e kuvendeve komunale. Sot ka me dhjetëra kërkesa për zëvendësime të këshilltarëve komunalë që presin për miratim nga KOZ-ja", është shprehur Hoti.

Veseli në Vjenë: Kosova ka përmirësuar ndjeshëm klimën e biznesit

VJENË, 8 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka hapur të premten në Vjenë Forumin Ekonomik Austri - Kosovë. Në fjalën e tij para biznesmenëve austriakë, kryeparlamentari Veseli ka thënë se Austria tradicionalisht ka qëndruar gjithmonë përkrah aspiratave të popullit të Kosovës për paqe, liri e progres. Ai ka shprehur kënaqësinë që Kosova ka arritur të tërheqë investime serioze austriake. Veseli ka thënë se prania e këtyre kompanive në Kosovë ka sjellë përvoja të reja në tregun vendor dhe ka krijuar një infrastrukturë të përshtatshme për afarizmin vendor dhe për investitorët e huaj. "Kam bindjen se ky forum biznesi do të shërbejë si katalizator dhe urë lidhëse solide për t'i shtuar marrëdhëniet ekonomiko-tregtare dhe për t'i nxitur investimet e ndërsjella mes Kosovës dhe Austrisë", ka theksuar Veseli. Duke folur për reformat financiare e ekonomike, si dhe për klimën afariste në Kosovë, Veseli ka deklaruar se Kosova prej vitësh ka ruajtur stabilitetin politik, atë makroekonomik dhe ka përmirësuar ndjeshëm klimën e biznesit, duke reduktuar drastikisht procedurat burokratike për të hapur dhe operuar një biznes.

Kryeparlamentari Veseli ka theksuar se Kosova është shpallur zyrtarisht si top reformatori në botë nga 185 shtete që janë në konkurrencë, duke lënë prapa shumicën e shteteve të rajonit për numrin e reformave që janë realizuar në dy vjetët e fundit. Në vazhdim të fjalës së tij, Veseli ka folur për përparësitë që kanë investitorët e huaj në Kosovë dhe avantazhet krahasuese të saj në raport me rajonin për thithjen e investimeve të huaja. Në këtë kontekst, Veseli ka potencuar pasuritë natyrore e nëntokësore të Kosovës, popullsinë e re dhe krahun e lirë të punës, si dhe pozicionin gjeografik të Kosovës në Ballkanin Perëndimor. "Kosova ka të rinj të mirarsimuar dhe të kualifikuar, ku shumë prej tyre flasin anglisht dhe gjermanisht. Prandaj, sektori i shërbimeve në përgjithësi mbetet motori i ekonomisë tonë. Vetëm në 10 vjetët e fundit janë më shumë se 30 mijë të rinj që janë punësuar në sektorin e ICT dhe në sektorin e nënkontraktimeve të biznesit 'outsourcë', ka thënë kreu i Kuvendit. Ai ka shtuar se Kosova synon të jetë një vend transit për projekte të rëndësishme ndërkombëtare të ndërlidhjes në fushën e infrastrukturës së transportit



dhe energjetikës. "Dua t'ju siguroj se dera ime është gjithnjë e hapur për ju dhe angazhimi im do të jetë përherë maksimal për t'ju lehtësuar përpjekjet tuaja për realizimin e projekteve investuese me interes të

dyanshëm të vendeve tona", është shprehur kryeparlamentari Veseli.

Ky forum është organizuar nga Oda Ekonomike Austriake në bashkëpunim me Ambasadën e Kosovës në Vjenë. Në këtë forum

morën pjesë mbi 100 përfaqësues të bizneseve austriake. Në hapje të Forumit Ekonomik Austri-Kosovën morën pjesë edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës që janë pjesë e delegacionit gjatë vizitës zyrtare në Austri.

Lekaj fajëson ish-ministrin Zharku për borxhin e 'Bechtel Enka'-s

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, në një konferencë me gazetarë mbajtur të premten, ka akuzuar Qeverinë e kaluar të Kosovës për gjobën 53 milionëshe në rastin e autostradës që e lidh Kosovën dhe Maqedoninë. Lekaj ka shpjeguar procesin që çoi në pagesën e dënimit prej 53.1 milionë eurosh për kompaninë "Bechtel Enka" rreth vonesave në ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit. "Ministria dhe qeveria kanë informata të duhura për t'i vlerësuar rreziqet kontraktuale për ndërprerjen e punës dhe ndikimin e arbitrazhit për investimet e huaja. Kur erdhëm në këtë Ministri ishim përballë një pagese mbi 60 milionë euro, por e zbritëm në 53 milionë euro", ka thënë Lekaj. Ai ka akuzuar qeverinë e kaluar të drejtuar nga Isa Mustafa dhe ministrin e Infrastrukturës në atë qeveri, Lutfi Zharku, për keqmenaxhim të buxhetit, duke

rialokuar paratë e destinuar për këtë autostradë në projekte më të vogla për të cilat tha se synim kryesor e kanë pasur votën. "Paratë janë rialokuar në 260 projekte komunale e rurale. Ish-ministri nuk ka qenë i gatshëm të merret me këtë çështje të shkakuar nga faji i vet", është shprehur ministri Lekaj. Ai ka pohuar se "Bechtel Enka" nuk ka të drejtë të bëjë kërkesë shtesë për buxhet dhe se me këtë marrëveshje përmbillet i tërë projekti që do të përfundojë më 31 dhjetor 2018. Ndërkaq të premten "Bechtel Enka" ka mirëpritur vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e 53 milionë eurove. "BEGP-ja është e gëzuar që çështja e kostove shtesë të pësuar nga BEGP duke punuar brenda ndarjes së kufizuar buxhetore të Qeverisë së Kosovës dhe riorganizimi i nevojshëm i punëve për t'u përshtatur me mungesat e alokimit të buxhetit për projektin më në fund është zgjidhur", është thënë në komunikatën për media. Qeveria e Kosovës kishte ndarë



53 milionë euro shtesë për kompaninë në fjalë për punimet e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit për shkak të, siç thuhet, dështimit të Qeverisë së kaluar që t'i

paguajë me rregull faturat. Por, pas debateve të nxitura dhe dyshimeve të ngritura nga partitë opozitare, Kryeprokuroria dhe Policia e Kosovës kanë nisur hetimet. Ato kanë bërë me

dije se janë duke mbledhur të dhëna lidhur me ndarjen e 53 milionë eurove për konsorciumin "Bechtel Enka" që është duke ndërtuar autostradën Prishtinë - Hani i Elezit.

Nënshkruhet marrëveshja për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Zvicrës



Në një ceremoni rasti në Prishtinë të premten është nënshkruar marrëveshja për sigurime sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, e cila i hap rrugë realizimit të të drejtave të qytetarëve të të dy shteteve në fushën e sigurimeve sociale

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, dhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, kanë nënshkruar të premten marrëveshjen për sigurime sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, e cila i hap rrugë realizimit të të drejtave të qytetarëve të të dy shteteve në fushën e sigurimeve sociale.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se kjo marrëveshje është e rëndësishme së veçantë sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë prek qytetarët e

Republikës së Kosovës dhe qytetarët zviceranë, të cilët do t'i realizojnë të drejtat e tyre siç janë, e drejta në pension të moshës, pension familjar dhe pension invalidor të punës. "Qytetarëve të Kosovës po iu kthehet një e drejtë të cilën nuk e kanë gëzuar shumë vite që nga ndërprerja e marrëveshjes e cila ka qenë e lidhur në mes të ish-Jugosllavisë dhe Zvicrës. Po u kthehet e drejta për t'i shfrytëzuar të mirat për të cilat me vite qytetarët kanë kontribuar dhe kanë derdhur djersën e tyre", ka thënë ministri Reçica. Ai ka pohuar se ndërprerja e marrëveshjes për sigurime sociale e lidhur në mes të Konfederatës së Zvicrës dhe ish-Jugosllavisë e vitit 1962, ka kri-

juar një zbrazëti ligjore në fushën e sigurimeve sociale në mes dy vendeve. Si rrjedhojë, qytetarët e dy vendeve, që nga viti 2010, në mungesë të kësaj marrëveshje nuk kanë mundur t'i realizojnë të drejtat e tyre në fushën e sigurimeve sociale në vendet e origjinës. "Me nënshkrimin e marrëveshjes së sotme po i hapet rrugë realizimit të këtyre të drejtave dhe në këtë rast falënderoj Qeverinë e Zvicrës dhe uroj qytetarët e Kosovës për këtë arritje të madhe për ta", ka thënë ministri Reçica.

Ambasadori zviceran në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, ka thënë se nënshkrimi i marrëveshjes është hap i rëndësishëm në marrëdhëniet dypalëshe të vendeve tona duke shënuar fundin e tri vjetëve të negociatave, ku në këtë rast ka falënderuar ministrin Reçica dhe ekipin e negociatave për bashkëpunimin e shkëlqyer. "Një nga qëllimet kryesore të marrëveshjes është të sigurohet që qytetarët kosovarë që kanë punuar për vite në Zvicër dhe u kthyen në vendin e tyre pas daljes në pension,

mund t'i marrin përsëri pensionet e tyre zvicerane në baza mujore duke jetuar këtu në Kosovë. Gjithashtu, marrëveshja synon ta forcojë bashkëpunimin midis vendeve tona në luftën kundër abuzimit të mundshëm të sigurimeve shoqërore", ka thënë ambasadori Lebet. Marrëveshja për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Zvicrës hyn në fuqi pas rati-

fikimit nga parlamentet e të dyja shteteve. Paraprakisht, Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e parë ndërkombëtare për Sigurime Sociale me Mbretërinë e Belgjikës në shkurt të këtij viti, e cila është nënshkruar nga ministri Reçica dhe ministrja belge e Punëve Sociale dhe Shëndetit Publik, Maggie De Block, në një ceremoni rasti në Bruksel.

BSPK-ja përshëndet nënshkrimin e marrëveshjes

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka përshëndetur nënshkrimin e marrëveshjes së re ndërshtetërore mbi sigurimet shoqërore në mes të Zvicrës e Kosovës. BSPK-ja ka kërkuar ratifikimin e saj sa më të shpejtë nga ana e parlamenteve të të dyja shteteve. "Ky ratifikim sa më i shpejtë mundëson që pas më shumë se tetë vjetëve pritje të marrë fund diskriminimi për një pjesë të mbetur ende gjallë të përfituesve legjitimë të pensioneve të tyre të merituar. Gjithashtu, kërkojmë t'i jepet fund dënimit kolektiv të përfituesve legjitimë, duke rregulluar e mundësuar përfitimin retroaktiv të pensioneve për periudhën kohore pa zbatim marrëveshjeje mbi tetëvjeçare", është thënë në komunikatën e BSPK-së.

Aksident në Ferizaj, humbin jetën tre persona

FERIZAJ, 8 QERSHOR (ER) - Tre persona kanë humbur jetën dhe një person ka pësuar lëndime të rënda trupore në një aksident trafiku që ka ndodhur në rrugën magjistrale Kaçanik - Ferizaj. Sipas një njoftimi të zyrës për informim në rajonin e Ferizajt, rasti ka ndodhur kur ngasësi i veturës nuk i është përshtatur shpejtësisë së lëvizjes dhe kushteve të rrugës. Me urdhër të prokurorit trupat e pajetë të viktimave janë dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduk-

sion.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, vetëm në katërmujorin e parë të këtij viti 29 persona kanë humbur jetën si pasojë e fatkeqësive në komunikacion derisa janë regjistruar rreth 5 000 aksidente. Me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të rasteve të shkeljeve ligjore në trafik, këtë vit në Kosovë janë ashpërsuar masat ndëshkuese, por statistikat nuk kanë treguar ndonjë përmirësim edhe pas marrjes së masave në fjalë.



Digjet një veturë dhe dëmtohen dy të tjera në kompleksin universitar

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Policia e Kosovës nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se sot në rrugën "Agim Ramadani" në Prishtinë, saktësisht në parkingun brenda kompleksit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" është djegur një veturë e tipit

"Mercedes".

Njësitët policore dhe zjarrfikësit kanë lokalizuar zjarrin, me ç'rast nuk ka asnjë person të lënduar, por vetëm janë shkaktuar dëme materiale. "Vetura e tipit 'Mercedes' është djegur tërësisht, ndërsa dy vetura të tjera (një Seat Ibiza dhe një Suzuki), të cilat

kanë qenë të parkuara afër, janë dëmtuar", është theksuar në komunikatën e policisë.

Aktualisht policia po vazhdon ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim të ndriçimit dhe sqarimit të rrethanave që kanë të bëjnë me rastin.



Ahmeti prezanton Prishtinën në konferencën e 'komunave të mençura'

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka qenë i ftuar në konferencën "Komunat e mençura dhe industrinë e energjisë eficiente 2018". Në këtë konferencë Ahmeti ka thënë se udhëheqja e një komune është adresa e parë për secilin problem të qyte-

tarëve. "Danimarka është vend nga i cili mund të mësojmë shumë. Praktikata e mira që janë zbatuar atje janë shumë të nevojshme që të zbatohen edhe në Kosovë, sidomos në fushën e energjisë së ripërtërishme. Ne si komunë e Prishtinës jemi qyteti i parë në Ballkan që kemi Planin e Qëndrueshëm të Mobilitetit

(SUMP), që ofron zgjidhje për problemet e shumta që i hasim çdo ditë në trafik", ka thënë Ahmeti. Ai ka thënë se për secilën komunë janë katër gjëra kryesore në të cilat duhet punuar: shërbimet administrative, zgjidhjet e mençura për problemet në qytet, reduktimi i shpenzimeve dhe transparenca.

Bahtiri urdhëron kompanitë që kabllot mbitokësore t'i vendosin nën tokë

MITROVICË, 8 QERSHOR (ER) - Pas rregullimit të qendrës së qytetit, asfaltimit të rrugëve dhe zëvendësimit të gypave të ujësjellësit, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ua ka dërguar një letër të gjitha kompanive që ofrojnë shërbime me kabllot mbitokësore, doemos ato duhet t'i vendosin nën tokë deri në fund të këtij viti. "Kompanitë që ofrojnë shërbime të



këtitilla përmes kabllorëve mbitokësore janë të obliguara që deri në fund të këtij viti ato t'i vendosin nën tokë. Ndaj kompanive që nuk e respektojnë këtë kërkesë do të ndërmerren masa përkatëse nga autoritetet komunale, duke ua pamundësuar kryerjen e shërbimeve të këtitilla", ka thënë Bahtiri. Ai ka treguar se

është duke u investuar shumë në rregullimin e mjedisit dhe infrastrukturën e qytetit. "Deri tash janë rregulluar bukur sheshet dhe rrugët kryesore të qytetit, janë në asfaltim e sipër edhe shumë rrugë të tjera. Këto investime kanë bërë që Mitrovica sot të duket më e bukur se kurrë më parë", është shprehur Bahtiri.

Roma nuk është bërë për një ditë



Izmi ZEKA

Nëse flasim për norma dhe koncepte politike, një gjë duhet të thuhet hapur, precedenti dhe kultura politike duhet trajtuar dhe konsideruar seriozisht nga kjo shoqëri. Bazuar në Kushtetutën dhe legjislacionin tonë, përfaqësimi i popullit në arenën ndërkombëtare bëhet nga presidenti i vendit.

Partitë politike të cilat kanë qenë të përfaqësuara në Kuvend kanë votuar këtë koncept politiko-juridik të përfaqësimit të popullit, pra këtë Kushtetutë. Gjithashtu, kanë të drejtën që të lidhin koalicionë në bazë të parimeve dhe

platformave politike për mënyrën dhe formën se si do të qeveriset vendi për periudhën e caktuar. Shantazhi, presioni dhe format tjera të ndikimit janë totalisht të papranuar në demokraci.

Dje, sot e duke vazhduar edhe nesër... disa deputetë të Kosovës në mënyrë flagrante po thërrasin për anashkalim të rolit të presidentit. Inatet politike nuk do të duhet të reflektonin në interesat nacionale. Tani jemi në finale të bisedimeve me Serbinë, nuk do të duhet të jetë temë se kush kryeson bisedimet, por cila është platforma finale. Përvoja personale e dëshmuar e presidentit është thesar që duhet ruajtur dhe marr në konsideratë në çdo dimension, e veçanërisht në bisedime me shtetin serb, ndaj të cilit ka dalë triumfues çdo herë që nga bisedimet në Rambuje.

Pse popullit nuk i duhet nxitja të këtij soji...sepse populli ynë

ka kaluar një etapë dhe histori të cilën nuk duhet të harrojmë por duhet të ecet përpara. Lufta me shtetin serb ka qenë dhe duhet të përmyllet me një kërkimfalje nga ana e shtetit serb (ana morale) dhe një marrëveshje nën garancinë ndërkombëtare me obligime ligjore. Dhe ne, nuk guxojmë që për qëllime politike të ndalohe hapi final. Populli i Kosovës është i interesuar të ecën përpara, duhet punoj për një bashkëjetesë normale duke mos harruar historinë. Precedenti është se në shtetin tonë përfaqësimi nga presidenti ka qenë edhe në kohën e ish-presidentit Rugova, edhe pse me kornizën kushtetuese roli i tij nuk ka qenë sikur me Kushtetutën sot. Ky është realiteti, në Kosovë ka një precedent që bisedimet të udhëhiqen nga presidenti i vendit. Nuk dua të mbajë anë por të gjithë intelektualët, politika, akademikët, duhet të thër-

rasin për një realitet, për një pastrim shpirtëror (catharsis) për një jetë normal, jo të bëhet thirrje për luftë civile dhe të ndjellë urrejtje në baze të përkatësisë politike si dhe të nëpërkëmbet institucioni për inate...

Është edhe një fakt tjetër mjaftë i rëndësishëm për zhvillimet e mëtuatjeshme të politikës së jashtme së Kosova nuk ka kohë që në takime të tilla të rëndësishme të veçantë historike të dërgoj njerëz të cilët ende nuk kanë kaluar kufijtë Kosovës apo edhe nuk kanë legjitimitetin demokratik. Kosova nuk guxon që në këtë fund të përballjes me Serbinë të luaj lojën e bixhozit për inate apo edhe histori të së kaluarës së njerëzve në mes veti. Tani jemi në fazën "kritike" të rrumbullakimit të historisë qindraveçare dhe kush më mirë është i përgatitur se presidenti i vendit të ballafaqohet edhe me këtë sfidë të quajtur bisedime.

Një thënie e mençur thotë se "Roma nuk është bërë për një ditë" prandaj në këtë konstelacion veprimet shtetërore nuk janë individuale as edhe personale. Çështjet me Serbinë do të kalojnë vite të tëra e do të mbetën problem i pazgjidhur. E rëndësishme në krejt këtë filozofi është qasja e institucioneve tona në raport me fqinjët, sidomos me Serbinë.

Ballafaqimi i shtetit të Kosovës me shtetin serb nuk duhet shikuar apo vlerësuar në prizmin e poenëve politikë. Kjo është përtej saj. Përtej individit dhe momentit politik. Kthehuni pak në histori. E njëjta praktikë e mirë e bisedimeve shtetërore ka ndodhur në mes dy superfuqive të mëdha ShBA-së dhe BRSS-së - Rusvelt - Stalin në vitin 1940 në një kohë të pakohë.

Për fund, Kosova do të këtë president e kryeministra edhe në të ardhmen dhe do të kontribuojnë në historinë e shtetit tonë.

Universiteti i Prishtinës promovon 10 doktorantë të rinj

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Në Sallën e Senatit të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të premtën është mbajtur ceremonia e gradimit të dhjetë kandidatëve në doktorë të shkencave. Kandidatët e shpallur doktorë të shkencave janë nga Fakulteti Filozofik, Juridik, Ekonomik dhe ai i Mjekësisë.

Rektori i UP-së, Marjan Dema, ka thënë se puna me përkushtim e kandidatëve ka bërë që ata të jenë këtu ku janë sot, duke bërë krenarë jo vetëm familjarët, por edhe UP-në. "Ju keni arritur deri tek ky moment në sajë të punës dhe përkushtimit tuaj, por edhe falë përkrahjes dhe familjes suaj. Ju bëtë krenarë familjet e juaja, mësuesit, profesorët dhe mua si të parin e UP-së dhe sot të gjithë ne po i gëzohemi këtij suksesi", ka thënë Dema. Ai ka

theksuar se UP-ja është duke punuar fuqishëm që të bëhet avancim në mësimdhënie, mësimxënie, kërkime shkencore, por edhe në shërbim ndaj shoqërisë. Përveç rektorit Dema, të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe prorektori për zhvillim dhe cilësi në UP, prof. dr. Hysen Bytyqi, dekani i Fakultetit Filozofik, prof. asoc. dr. Bujar Dugolli, dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. ass. dr. But Dedaj, prodekanja e Fakultetit Juridik, prof. asoc. Iliriana Islami dhe prodekanja i Fakultetit të Mjekësisë, prof. ass. Kreshnik Hoti.

Në cilësinë e promotorëve të kandidatëve ishin profesorët; Gazmend Rizaj, Rexhep Gashi, Bedri Peci, Enver Kutllovci, Skënder Ahmeti, Naser Ramadani, Shaip Krasniqi, Halit Ymeri, Metush Disha dhe Resmije Ademi.



KANDIDATËT E SHPALLUR DOKTORANTË JANË:

Shpend Avdiu
Miftar Shala
Fitore Morina
Albana Berisha-Qehaja
Albulena Shala
Drita Kutllovci-Zogaj
Armond Daci
Arben Kutllovci
Kastriot Meqa
Jehona Ahmed

Kosova duhet të përgatitet për parandalimin e zjarreve në sezonin e verës



PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh bashkëthemelues i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka reaguar për mundësitë e zjarreve fushore dhe pyjore që mund të ndodhin gjatë muajve të verës në Kosovë dhe për masat parandaluese që duhet të ndërmerren. "Çdoherë para muajve të verës duhen bërë

përgatitjet maksimale profesionale për parandalimin dhe pakësimin e zjarreve fushore dhe pyjore. Duhet të përfshihet komuniteti lokal i atyre zonave ku zakonisht ndodhin zjarret qoftë me trajnime të pjesëtareve të komunitetit, qoftë me fletushka vetëdijësuese të përgatitura për mënyrën e parandalimit dhe luftimit të këtyre zjarreve", ka thënë Ahmeti. Ai ka bërë me

dije se duhet të bëhen fushata sensibilizuese, gjithëpërfshirëse para sezonit të verës, duke paralajmëruar qytetarët për sanksionet ndëshkuese nga shkaktimi i zjarreve të qëllimshme. "Duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, inicimi i zjarrit që është me rrezik të përgjithshëm është vepër penale dhe sanksionohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet", ka deklaruar Ahmeti.

Krahu lindor i NATO-s kërkon prani të shtuar detare dhe ajrore

VARSHAVË, 8 QERSHOR - Nëntë shtetet e krahut lindor të NATO-s në një takim organizuar të premtën në Varshavë kërkuar forcim të pranisë së Aleancës së Atlantikut në rajonin e tyre, aktualisht i kufizuar vetëm me forca tokësore, për një zgjerim të mundshëm me komponentë detare dhe ajrore,

deklaroi presidenti polak, Andrzej Duda.

Kjo kërkesë u parashtrua gjatë diskutimit për sigurinë në Detin e Zi, pohoi Duda, i cili dha shpjegime për këtë çështje me homologun rumun, Klaus Iohannis në pjesën e parë të punimeve të presidentëve të "B9" (Bullgari, Estoni, Hungari,

Letoni, Lituani, Poloni, Rumani, Sllovakia dhe Republika Çeke, kjo e fundit u përfaqësua nga kryetari i Parlamentit dhe grupi u pagëzua "Nëntë të Bukureshtit" që prej takimit të tyre të parë në Rumani në vitin 2015. "Këto shtete ranë dakord nëse do të ishte i nevojshëm për ta forcuar praninë e

NATO-s, me një komponent detar dhe një komponent ajror për të arritur një spektër të plotë", siguroi Duda.

Homologu i tij rumun vuri theksin në rëndësinë e Detit të Zi, pasi kjo zonë është pikërisht aty ku ne jetojmë, me kërkesën për një afirim gjithëpërfshirës të krahut lindor.



Irani i bën thirrje botës t'u rezistojë taktikave amerikane

Ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif ka thënë se ka kërkuar që Iranit t'i kompensohen humbjet ekonomike që rezultojnë si pasojë e tërheqjes së ShBA-së nga pakti bërthamor



TEHERAN, 8 QERSHOR - Ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif u ka kërkuar fuqive botërore të jenë të përkushtuara ndaj marrëveshjes bërthamore dhe t'u rezistojnë atyre që ai i ka cilësuar si "taktika ngacmuese" amerikane. Diplomati iranian ka thënë se ka kërkuar që Iranit t'i kompensohen humbjet ekonomike që rezultojnë si pasojë e tërheqjes së ShBA-së nga pakti bërthamor. Në një letër të publikuar në "Twitter", Zarif ka thënë se në mënyrë që të "mbijetojë" marrëveshja, shtetet e tjera nënshkruese duhet t'i mbulojnë humbjet e Iranit të shkaktuara nga dalja e ShBA-së dhe planet e kësaj të fundit për të rivendosur sanksione, të cilat i ka tërhequr më herët në pajtim me marrëveshjen bërthamore. Zarif ka thënë se "disa nga përfitimet më të rëndësishme ekonomike të

Iranit nga marrëveshja bërthamore janë si rezultat i heqjes së sanksioneve të Shteteve të Bashkuara" dhe Irani tani po kërkon të përcaktojë se "si mund t'i garantojnë pjesëmarrësit e mbetur dhe partnerët ekonomikë përfitimet e plota që populli iranian ka të drejtë t'i ketë". Zarif ka paralajmëruar se nëse, pas shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, të drejtat dhe përfitimet e popullit nuk kompensohen, është e drejta e padiskutuueshme e Iranit t'i marrë veprimet e duhura në përgjigje të tërheqjes së SHBA-së. Kërkesa e Zarifit për kompensim nga fuqitë e tjera botërore që kanë nënshkruar marrëveshjen vjen pasi një numër i madh i bizneseve kanë njoftuar se do të largohen nga Irani për shkak se mund të përballen me gjoha miliarda dollarëshe nga ShBA-ja, nëse shkelin sanksionet

amerikane.

Në mesin e kompanive që kanë njoftuar për largim të plotë ose të pjesshëm janë Total, Renault, Reliance, Allianz, DZ Bank, Danske Bank, BCP Maersk dhe KBC. Analistët kanë vlerësuar se humbjet ekonomike do të jenë miliarda dollarë në rast të largimit të këtyre kompanive nga Irani. Në letrën e tij drejtuar ministrave të Jashtëm botërorë, Zarif ka thënë se kërkesat e Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, të prezantuar pas tërheqjes së ShBA-së nga pakti, siç është largimi nga Siria dhe moszhvillimi i raketave balistike, rrezikojnë tërë rregullin botëror. "Kërcënimet e tij kundër kombeve të tjera do ta bëjnë botën peng të diktateve ekonomike dhe politike të kësaj administrate", është shprehur diplomati iranian.

LAJME SHKURT



Në Kanada ka nisur samiti i G-7

OTAVË, 8 QERSHOR - Presidenti Donald Trump ka shkuar në Kebek të Kanadasë, për të marrë pjesë në takimin e G-7-s. Para nisjes për në takim, ai dha një konferencë për shtyp, dhe tha se "Rusia duhet të ftohet përsëri që të marrë pjesë në takimet e udhëheqësve botërorë të vendeve më të industrializuara".

Një tjetër pjesëmarrës në takimin e G-7-s, kryeministri italian Giuseppe Conte tha përmes një "tweet"-i se e mbështet sugjerimin e Trumpit.

Por një zëdhënës i kryeministrit kanadez Justin Trudeau, që këtë herë është organizatori i takimit, tha se Kanadaja vazhdon të jetë kundër ripranimit të Rusisë në grup. Ndërkohë, sipas Agjencisë ruse të lajmeve "Sputnik", zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, citohet të ketë thënë se "Rusia është përqendruar në grupime të tjera, përveç G-7-s".

Rusia iu shtua forumit në vitin 1997, që u bë i njohur si G-8a një vit më vonë. Por ajo u përjashtua nga takimi i vendeve më të industrializuara të botës në vitin 2014, pas aneksimit të Krimesë nga Moska.

Presidenti Trump tha se do ta zgjidhë çështjen e marrëveshjeve të padrejta tregtare të vendeve aleate me Shtetet e Bashkuara gjatë dy ditëve të takimit të G-7-s.

Putini, vizitë zyrtare në Kinë

PEKIN, 8 QERSHOR -

Presidenti rus Vladimir Putin të premtën ndodhej në Kinë për një takim me presidentin kinez Xi Jinping. Vizita shtetërore thekson faktin se si presioni në rritje i Shteteve të Bashkuara po i afrohet dy vendet gjithnjë e më pranë njëri-tjetrit.

Rusia dhe Kina i janë përgjigjur Strategjisë së Sigurisë Kombëtare Amerikane që i karakterizon ata si kundërshtarët kryesorë të Amerikës, duke u zotuar ta zgjerojnë më tej bashkëpunimin e tyre ekonomik, politik dhe ushtarak. Sipas një zyrtari rus, dy presidentët Putin dhe Xi janë takuar pesë herë vetëm vitin e kaluar.



Austria mbyll shtatë xhami

VIENË, 8 QERSHOR - Austria tha se do të mbyllë shtatë xhami dhe se do t'i dëbojë imamët që, sipas saj, financohen nga qeveri të huaja. Kancelari austriak Sebastian Kurz tha se këto masa janë goditje mbi islamit politik.

Disa xhami dyshohet se kanë lidhje me nacionalistët turq. Zyra e presidentit turk e cilësoi veprimin e Austrisë si "islamofobik, racist dhe diskriminues". Qeveria austriake tha se 60 prej 260 imamëve në vend po heto-

hen, nga të cilët 40 i përkasin ATIB-it, një grup mysliman i afërt me Qeverinë turke. "Shoqëritë paralele, islami politik dhe tendencat e radikalizimit nuk kanë vend në Austri", tha kancelari Kurz.



Filialet e shërbimeve sekrete jugosllave në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame (4)

- Hoxhallarët komunistë marksistë-leninistë jugosllavë dhe nacionalistët shqiptarë



Bardhyl MAHMUTI

Lexuesit i kujtohet se me paratë që mernte nga Shërbimi Sekret për t'i korruptuar njerëzit e varfër, Sulejman Rexhepi "një dinar ua jepte atyre e dhjetë i mbante për vete". Lidhur me raportin e tij ndaj parasë, Sulejman Rexhepi përshkruan rrethanat kur njerëzit e Shërbimit Sekret i zunë pritën kur ky kishte dalë në gjueti. "Kisha dalur për gjueti kur që të tre më dolën në rrugën malore dhe, thjesht, më çarmatosën. Kiros i vinte keq, ndërsa ata dy më zhveshën në brekë e maicë! M'u kërcënuan keq. Ju thashë, më vrani, para nuk jap. Ku do të jipja para unë që, për paranë e lija kokën, bëja punët më të fëlliqta vetëm e vetëm ta shtoja buxhetin tim familjar. Tani a edhe për kaurë do të punoja! Mjaftonte kontributi im prej spiuni. Para nuk jap! I kam për vete... (Memoari nr. 50).

Memoaret e publikuara të Sulejman Rexhepi, që edhe sot e kësaj dite është kryetar i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, janë të mbushura me emra dhe mbiemra të atyre teologëve që kanë punuar për Shërbimin Sekrete Jugosllav. Siç pohon edhe vetë Sulejman Rexhepi, këta "hoxhallarë komunistë, marksistë-leninistë jugosllavë kanë urreyer marksizëm-leninizmin e enveristëve, për arsye se kanë dashur ta prishin Jugosllavinë".

Nëse dikush nga teologët

shqiptarë nga viset e tjera shqiptare që ishin të pushtuara nga ish-Jugosllavia, që ka punuar për Shërbimet Sekrete Jugosllave, merr guximin e Sulejman Rexhepi, besimtarët myslimanë shqiptarë do të tronditeshin shumë. Kjo tronditje do t'i ndihmonte teologët e rinj që bënin ndarjen e besimit nga shërbimet antishqiptare.

Kërkesa e teologëve që t'u sjell emra të njerëzve që punojnë kundër interesave kombëtarë shqiptarë dhe memoaret e Sulejman Rexhepi më kujtuan një situatë, të cilën ma ka treguar një shok i UÇK-së. Një bashkëpunëtor i Shërbimit Sekret Serb, bashkëfshatar i tij, kishte ardhur me qëllim që të infiltrohej në radhët e UÇK-së. Pasi u zbulua, nga frika filloi të tregonte gjithçka. Kur filloi të tregonte emrat e bashkëpunëtorëve të Shërbimit Sekret të Serbisë që vinin nga fshati i tij, shoku im më tha: "Bardhyl, dola nga dhoma, se kisha frikë mos po del edhe babai im. Sa u lehtësova kur mora vesh se në mesin e spiunëve serbë nuk kishte qenë im atë".

Po i drejtohem drejtpërdrejt Mustafë Bajramit. Pse kërkon emra nga unë, kur ke mundur të pyesësh babanë tënd, teologun Mulla Jetish Bajramin? Ndoshta do të të kishte informuar se cilët teologë të Kosovës mbanin lidhje me Serbinë, cilët prej tyre villnin vrer kundër demonstratave të vitit 1981 me të njëjtin fjalor që përdor Sulejman Rexhepi, cilët bënin propagandë gjatë viteve '90 për të dalë në zgjedhje në kuadër të zgjedhjeve që organizonte pushteti i Millosheviqit? Sikur të kisha qenë në vendin tënd, unë do ta bëja një pyetje të tillë. Meqenëse ke nevojë të

sqarohen publikisht këto gjëra, unë do ta bëj për të kënaqur kureshtjen tënde.

Babai im, profesor i logjikës, i filozofisë dhe i sociologjisë në gjimnazin e Tetovës, dhe këshilltar i Arsimit për Tetovën dhe Gostivarin, asnjëherë nuk ka qenë anëtar i asnjë strukture të komunistëve jugosllavë e as i ndonjë partie politike. Në shkurt të vitit 1969, si nacionalist shqiptar u dënua nga "komunistët marksistë-leninistë jugosllavë". Pas vuajtjes së dënimit në burgun e Idrizovës, ai nuk mundi të gjente punë në vendlindje. Erdhi dhe gjeti punë në Kosovë, në vendin ku "kuvendohej shqiptarçe dhe prej nga Sulejman Rexhepi kishte ikur në Arabi, që ta spastronte trurin nga ai infektim nacionalist". Erdhi nga Tetova, qytet i Kosovës historike të cilin komunistët jugosllavë ia kishin falur republikës sllavo maqedonase, në Prishtinë, qytet që komunistët jugosllavë ia kishin falur Serbisë pas ndarjes si plaçkë të territoreve shqiptare.

Kur i botoi memoaret e veta, Nafi Çegrani, të cilin Sulejman Rexhepi e cilëson si "udbashi më i rreptë dhe, njëkohësisht, më i sinqertë shqiptar", ai publikoi emrat e intelektualëve shqiptarë në Maqedoni, që ishin bashkëpunëtorë të sigurimeve sekrete jugosllave. Unë nuk pata nevojë ta pyes babanë tim, sepse Nafi Çegrani tregon me emër dhe mbiemër personat që ishin ngarkuar nga sigurimi sekret që të përcillte veprimtarinë e babait tim.

Sa u përket teologëve shqiptarë, të cilidto besim fetar qofshin, askush nuk mund ta mohojë kontributin e madh të tyre gjatë historisë si

në aspektin e ruajtjes dhe të kultivimit të tolerancës fetare, ashtu dhe në aspektin e çështjes kombëtare shqiptare. Atyre që u intereson të njihen me veprimtarinë e një numri të madh të personaliteteve të shquara shqiptare nga gjiri i teologëve, ju sugjeroj të lexojnë veprën e Faton Mehmetajt, të titulluar "Prijsë fetarë dhe shpirtërorë shqiptarë - Bashkëjetesa ndërjetare dhe kontributi i tyre kombëtar".

Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin e një numri teologësh me Shërbimet Sekrete Jugosllave, unë nuk kam asnjë paragjykim për asnjë teolog shqiptar. As për ata teologë që polemizojnë me mua. Kam bindjen se shumica dërmuese e teologëve shqiptarë nuk kanë bashkëpunuar me këto shërbime sekrete. Së paku kjo është dëshira ime.

Qëndrimet e mia janë kundër atyre teologëve myslimanë shqiptarë me shpirt shkau, që kishin hyrë në shërbim të Shërbimeve Sekrete Jugosllave. Janë ajo kategori e njerëzve të ulët, që, siç pohon vetë spiuni i UDB-së, Sulejman Rexhepi, me ndihmën e "marksistë-leninistëve jugosllavë ishin shndërruar në ekspertë për tredhjen e shqiptarëve nëpër stacione policore, ndërkohë që ua mbanin bolet në duar udbashëve".

Megjithatë, askush nuk mund të mohojë se akuzat e teologëve Mustafa Bajrami dhe Muhamed Kajolli janë gjuhë dhe terminologji e sajuar në kuzhinat e shërbimeve sekrete. Çdokush që ka lexuar memoaret e Sulejman Rexhepi, apo edhe vetëm këtë pjesë të cituar nga "dromcat e memoareve" të tij, mund të bindet se këta teologë nuk sjellin asgjë origji-

nale në shpifjet kundër "Bardhyl Mahmutit".

Çdokush që ka lexuar memoaret e Sulejman Rexhepi, kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni, e ka të qartë se "hoxhallarët komunistë" të edukuar në frymën e "marksizëm-leninizmit jugosllav, ishin mishëruar me historinë e huaj". Është e kuptueshme se, si rezultat i këtij mishërimi një numër teologësh myslimanë shqiptarë kishin "emocione të fuqishme sa trupin ua përshkonte një zjarr kur dikush i identifikonte me figurat historike sllave, si Gjorçe Petrovi". Është e kuptueshme se këta teologë të "marksizëm-leninizmit jugosllav" kurrë "nuk kanë ndjerë emocione më vonë, kur dikush i identifikonte me Skënderbeun". Prandaj, është edhe më e kuptueshme se pjella e një edukimi të tillë ka si rezultat faktin që edhe sot e kësaj dite, një numër teologësh marksistë-leninistë jugosllavë shajnë në mënyrën më të poshtër Skënderbeun, Nënë Terezën, Ismail Kadarenë dhe figura të tjera të historisë dhe kulturës kombëtare shqiptare.

P.s.

Po e përsëris: Memoaret e Sulejman Rexhepi janë memoaret më interesante të shkruara për raportet e teologëve me shërbimet sekrete. U sugjeroj të gjithë shqiptarëve t'i lexojnë këto dromca memoaresh, se kanë çfarë të mësojnë.

Të gjitha citatet nga këto memoare janë përshkruar besnikërisht, duke ruajtur edhe gabimet e shumta drejtshkrimore.

(Fund)

Qendrës Kinematografike të Kosovës i premtohet rritje e buxhetit

PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar Qendrën Kinematografike të Kosovës (QKK). Në takim me drejtorin e QKK-së, Arben Zharku, ministri Gashi ka shprehur përkushtimin e MKRS-së në mbështetjen edhe më të madhe ndaj kinematografisë vendore. Në këtë takim u diskutua për gjendjen aktuale të kinematografisë, hartimin e ligjit të ri të kinematografisë bashkë edhe me lehtësirat finan-

ciare.

Ministri Gashi ka uruar për sukseset ndërkombëtare që po i sjell filmi Kosovës dhe u zotua që rritja buxhetore ndaj Qendrës Kinematografike këtë vit të jetë 1 milion euro, buxhet i cili pritet të ketë rritje edhe më shumë në vitet në vijim.

Në takim u diskutua edhe për hapat e mëtejshëm që duhet t'i bëjë Kosova që sa më parë të bëhet pjesë e Programit Media pas anëtarësimit në Evropën Kreative.



E rrallë

Avioni përplasjet me helikopterin në ajër

Një avion i vogël është përplasur me një helikopter në ajër. Pamjet të cilat po qarkullojnë në rrjetet sociale tregojnë përplasjen e helikopterit Robinson R22 dhe një Piper PA-28 në aeroportin e Clearwater Airport në Florida.



FOTO E DITES



Shtëpitë e braktisura në ishullin Shengshan në provincën lindore të Kinës të mbuluara me bimësi të madhe. /Foto: AFP/

E jashtëzakonshme

Studenti që ha 150 banane në javë

Një student ka zbuluar se hanë çdo javë rreth 150 banane. Dane Nash fillon ditën e tij duke pirë lëng me 12 banane dhe spinaq, që me pas të hajë 10 të tjera. 21-vjeçari beson se rreth 80 % e kalorive vjen nga frutat, prandaj e vazhdon këtë rutinë edhe pse dietologët e këshillojnë se nuk është veprim i duhur.



BARSOLETA E DITËS



- Pse nuk je përgatitur për provim?
- S'e më ka vdekur gjyshja.
- Pranoni ngushëllimet e mia! Po ju jap një 7-she.
- Profesor, a bën 8, se shumë e kam dashtë gjyshen?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

“ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

“I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Karriera dhe dashuria janë në një ekuilibër të përkryer ditën e sotme. Veproni me qetësi sot dhe do t'ia dilni.</p>	 <p>DEMI Sot emocionet do të mbizotërojnë në ditën tuaj. Do të jenë emocione të mira, kështu që nuk keni pse të shqetësoheni.</p>	 <p>BINJAKËT Është mirë që sot t'i kushtoni rëndësi shëndetit dhe qetësisë shpirtërore. Keni disa kohë që jeni shumë në ankth për situata të caktuara.</p>	 <p>GAFORRJA Planetët gjenden në harmoni sot në shenjën tuaj. Kjo do të sjellë një gjendje shpirtërore mjaft të mirë dhe dëshirë për argëtim.</p>	 <p>LUANI Fjalët do të ndikojnë shumë sot në rrjedhën e gjërave. Ajo çfarë do të thoni do ta bëjë diferencën në një moment të caktuar.</p>	 <p>VIRGJËRISHA Sot do të merreni me punët e shtëpisë tuaj dhe jeni shumë të zënë me çështjet profesionale. Kërkoni ndihmën e një miku.</p>
 <p>PESHORJA Edhe pse sot jeni shumë të stresuar për shkak të një problemi, do të arrini t'i mbani nën kontroll emocionet tuaja.</p>	 <p>AKREPI Sot do të pendoheni për diçka që i keni bërë partnerit. Një ndjenjë e lehtë për dikë tjetër ju ka prishur ekuilibrat në marrëdhënie.</p>	 <p>SHIGJETARI Një ndjenjë e fortë miqësore sot do të shndërrohet në pasion. Do të lidheni shumë me dikë që ka qenë miku juaj.</p>	 <p>BRICJAPI Një udhëtim pune do të dalë më i frytshëm nga sa e mendonit. Shumë shpejt do t'ju duhet të merrni një vendim të rëndësishëm.</p>	 <p>UJORI Sot do ta ndiqni zemrën në të gjitha vendimet që do të merrni. Në shumë raste edhe mund të gaboni, duhet të zgjidhni me arsye.</p>	 <p>PESHQIT Intuita ju çon të mendoni një zgjidhje të shpejtë për një problem që do të dalë sot gjatë ditës. Nuk do të gaboni në zgjedhjen tuaj.</p>

Vdes aktori i famshëm, gjendet pa jetë në apartamentin e të dashurës



Ylli i "Son of Anarchy", Alan O'Neill, është gjetur i vdekur në banesën e të dashurës së tij. Trupi i aktorit irlandez u zbulua të mërkurën në korridorin e apartamentit të saj. Policia raporton se nuk ka dyshime për vrasje, ndërsa

raportohet se 47-vjeçari kishte probleme të zemrës si dhe konsumonte shumë alkool dhe duhan. Ai ka nisur karrierën si aktor në vitin 1997, por më së shumti është i njohur për rolin e tij si Hugh në "Son of Anarchy".

Meghan Markle dhe Princi Harry duan të kenë një fëmijë menjëherë



Nuk është sekret që Meghan Markle dhe Princi Harry po planifikojnë të fillojnë një familje. Edhe para dasmës së tyre mbretërore muajin e kaluar, çifti foli hapur për planet e tyre për të pasur

fëmijë. Një burim i afërt ka thënë për "Us Weekly" se Meghan dhe Harry "duan të fillojnë menjëherë një familje dhe do të fillojë të përpiqet sa më shpejt të jetë e mundur për ta ngelur shtatzënë".



Trejsi Sejdini shpallet 'Miss Universe Albania'

Trejsi Sejdini është fituesja e kurorës së "Miss Universe Albania 2018". Ajo do të jetë përfaqësuesja e Shqipërisë në kompeticionin e bukurisë që do

të organizohet në Amerikë. Nga tri vajzat që mbetën në fund të garës, vendin e dytë e mori Irene Dama, ndërsa e treta u rendit Ajli Hoxhaj.

Johnny Depp s'ka probleme me shëndetin



Johnny Depp është mirë me shëndet, pavarësisht prej shqetësimeve të fansave për humbjen drastike të peshës kohët e


fundit. "Johnny është i shëndetshëm dhe po i shijon shfaqjet me grupin e tij Hollywood Vampires", ka thënë një burim për revistën "Us Weekly".

Dashuria sekrete e Churchill që mund të ndryshonte fatin e Luftës Botërore

Kreu i shtetit anglez kishte një marrëdhënie sekrete me Doris Delevingne, halla e madhe e modeles së famshme, Cara Delevingne. Një marrëdhënie "skandaloze" që mund ta kishte kompromentuar

Winston Churchill kishte një marrëdhënie të fshehtë, e cila mund të rrezikonte fatin e qeverisë së tij dhe madje edhe Luftën e Dytë Botërore. Kjo gjë është zbuluar nga një intervistë e pabotuar deri më tani, me asistentin e tij më të rëndësishëm.

seksi, e konsumuar në Ritz në Paris, ku duket se Churchill i ka thënë pas një nate dashurie, "Doris, ti do të ngrije përsëri edhe një kufomë". Nuk është e lehtë të mendosh për Churchill, – heroi i ardhshëm i Luftës së Dytë Botërore, madhështia e të cilit



Zbulimet, të cilat përshkruajnë marrëdhëniet e Churchill me gruan e tij, Clementine, shpesh të përshkruara si të pakundërshtueshme, në një dritë më komplekse, dalin në një dokumentar të serisë së "Historive sekrete të rrjetit anglez" në Channel 4, bazuar në hulumtimet e Richard Toye, profesor i historisë në Universitetin e Exeter dhe Warren Docket, historian ndërkombëtar në Universitetin e Aberystwyth. Të dy akademikët zbuluan se në vjeshtën e vitit 1985, ish-sekretari privat i Churchill, Sir John "Jock" Colville, dha një intervistë të gjerë ndaj arkivistëve të "Churchill College" në Kembrixh, por që asnjëherë nuk është bërë publike deri më tani.

Kjo intervistë konfirmon faktin se Churchill kishte pasur një marrëdhënie të fshehtë me një aristokrate "joshëse", zonjën Doris Castlerosse, lindur në Delevingne dhe halla e madhe e supermodelles së famshme, Cara Delevingne. Kur filloi marrëdhënia, Churchill po kalonte një periudhë depresioni. Ishte jashtë Parlamentit pas humbjes së konservatorëve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1929 dhe kishte humbur një pasuri në rrëzimin e 'Wall Street Crash' të po atij viti.

Për pasojë u zhyt në një jetë intensive shoqërore: pinte dhe luante kumar, si dhe udhëtonte shpesh. Ndërsa ai ishte i ftuar në vilë në Francë, te Lord Beaverbrook, në vitin 1930, u prezantua me bukuroshen Doris Delevingne. Mes tyre do të lindte një histori

është e përfaqësuar mirë në filmin "The Darkest Hour", si një playboy kushtuar aventurave jashtëmarte-sore. Por, tani dëshmia historike konfirmon episodin dhe si dhe shumë të tjerë të jetës aventureske të Delevingne.

Duket se fuqia e Lady Castlerosse mbi Churchill ishte e madhe dhe halla e madhe e Cara Delevingne u përshkrua nga një kushëri si "gruaja më arrogante, kapriçioze, më e paturpshme dhe estetikisht më e bukura në Londër". Doris Delevingne ishte në fakt një joshëse e gjykatës në brazdën e traditës së Lady Hamilton dhe Nell Gwyn, e cila lidhej me njerëz të pasur dhe jetonte në rehati që ata i jepnin gjatë përlules së tyre.

Duket se zonja i kishte vënë syrin edhe mbretit Edward VIII, por që nuk kishte pasur sukses, sepse ishte mundur nga Wallis Simpson,



po aq ambicioze dhe agresive. Doris vinte nga një familje e vogël borgjeze nga Streatham, në jug të Londrës. Dhe vetëm përmes frekuenteve të sakta, kishte arritur t'i afrohej aristokracisë angleze. Nga marrëdhëniet e saj me burrat e pasur ajo arriti të merre para, bizhuteritë Cartier, rrobat e Schiaparelli dhe çizme mëndaf-

pas martesës në vitin 1928, ajo vazhdoi jetën e saj të lirë, të mbushur me sulme të rënda fizike nga burri i saj. Dy vjet më vonë, ajo joshi Winston Churchillin në vitin 1930. Më vonë thuhet se kishte një marrëdhënie edhe me djalin e tij, Randolph Churchill, i cili ishte vetëm 21 vjeç. Marrëdhënia e tyre u zbulua nga pronari i Cavalry



shi në Paris. Reputacioni i saj i keq e paraprinte atë dhe e bënte edhe më interesante. Një e njohur i sugjeroi të shkruante një libër të quajtur "Rreth Botës në 80 shtretër". Ajo ra në dashuri me një "playboy" të gjatë dhe të bukur amerikan, Laddie Sanford, i cili pastaj e la atë për gruan e Mountbatten. Edhe



Club, i cili hapi derën e një dhome dhe pa këmbët e pagabueshme të Doris ngritur në qiell, ndërsa Randolph Churchill i thirri atij: "Jashtë!" Shpejt, çështja ishte në domenin publik dhe babai – thotë Lyndsy Spence në librin e tij mbi Doris Delevingne "The Mistress Of

Mayfair", – i kërkoi djalit të tij t'i jepte fund lidhjes.

Doris dhe Randolph u ndanë. Megjithatë, ajo vazhdoi të mbante kontakte me Winston dhe kur u takuan përsëri në një festë në një vilë në jug të Francës, Churchill i mori atë në një foto, veshur me pantallona të shkurtra që shpesh i vishte për të treguar këmbët e saj të bukura. I tillë ishte besimi i saj në fuqitë e saj joshëse që çoi në shtrat edhe fotografimin e famshëm, Cecil Beaton, edhe pse sipas fjalëve të tij, ai ishte "tmerresisht homoseksual". Besova se mund ta "kuroja", por dështova. Ndërkohë, në vitin 1938, martesa e saj përfundoi. Por ajo gjeti një adhuruese të re, Margot Hoffman, një pasanike amerikane, me të cilën filloi një marrëdhënie homoseksuale.

Margot bleu një pallat në Venecia për të argëtuar miqtë e tyre, por kur lufta shpërtheu në vitin 1939, Italia u bë një vend armik dhe Doris iku në Nju Jork me miken e saj. Megjithatë e mbante kontaktin me Churchill, edhe pse ajo filloi të bëhej një figurë e pakëndshme për miqësinë e saj intime me fashistin Oswald Mosley. Marrëdhënia me miken amerikane hyri në krizë dhe Doris i bëri thirrje Churchillit të kthehej.

Ajo kishte me vete atë portret të pikturuar prej tij në Francë dhe kreu i shtetit me siguri nuk dëshironte, në një moment delikat në marrëdhëniet me Uashingtonin, që në gazetë të shfaqej titulli "Winston dhe kurtizana". Operacioni i rikthimit, në kohë lufte, nuk ishte i lehtë. Në një udhëtim në Amerikë në vitin 1942, Churchill hipi në avionin e tij dhe e solli përsëri në Londër. Kthimi në atdhe nuk ishte, megjithatë, i lavdishëm dhe Doris duhej të shiste bizhuteritë e saj dhe të mer-


rte çmime të ndryshme, një akt i paligjshëm në kohë lufte. Pak pas kësaj, në moshën 42 vjeçe, ajo u gjet në një hotel, e vdekur nga mbidoza. Me të u zhdukën edhe sekretet e marrëdhënies me udhëheqësin më të famshëm britanik në histori. (gazeta-Shqip.com)

Rodos, “sekretet” e ishullit shumë të dashur nga Apollo

Aromat e pyjeve me pisha dhe Egjeut, plazhet e pafundme dhe uji i pastër. Dhe qytetet fantastike mesjetare

Më shumë se një milion turistë e vizitojnë atë çdo vit: Rodos, me plazhe kilometra të gjata dhe male të mbuluara me pyje aromatike, fshatra malorë, vende arkeologjike dhe një qytet mesjetar me bukuri të jashtëzakonshme është një nga atraksionet më intriguese të Greqisë. Rodos, i

lidhur me Italinë nga një histori e gjatë, është ishulli më i madh i Dodekanezit me një bregdet prej 220 kilometrash dhe një popullsi që tejkalon 100 mijë banorë. Gjithashtu i njohur për Kolosin legjendar të Rodosit, një nga shtatë mrekullitë e botës së lashtë, ishulli njihet gjithashtu me



nofkën ‘Rose Island’, lidhur me natyrën fatlume të vendit, të përkëdhelur nga erërat e vakëta dhe të karakterizuar nga një det kristalor.

Apollo dhe Nimfa – Poeti grek Pindar shkruan se ishulli ishte themeluar nga bashkimi i Apollonit, perëndisë së diellit me Nimfën e detit Rodos. Përmes Rodosit kalon gjithë bota e lashtë: nga Akejt 1500 vjet para Krishtit, te Dorianët që ndërtuan Lindon.



Shkollat e filozofisë së tij rivalizuan athinasit dhe Aleksandrinët. Romakët ruanin karakteristikat e një qendre të madhe emporiale. U mbizotërua nga bizantinët dhe pastaj nga kalorësit mesjetarë, gjë që la gjurmë të mrekullueshme. Ai ishte gjithashtu italian nga viti 1912 deri më 1947, kur u kthye në Greqi.

Ndër qytetet më të bukura të botës – Rodos, kryeqendra, përveçse është konsideruar si një nga qytetet më të bukura të botës, karakterizohet nga një qytet i

vjetër mesjetar i rrethuar nga katër kilometra mure: është e mrekullueshme të ecësh sidomos në mbrëmje në mesin e rrugicave piktoreske të qytetit të vjetër, në mes të rrugicave të ngushta dhe pallateve të mëdhenj kalorësiakë, duke u ndalur në shumë restorante dhe dyqane tipike të vendit. Janë gjithashtu për t'u vizituar muzeu interesant bizantin dhe muzeu arkeologjik, ku ruhet statuja madhështore e Venusit të Rodosit. Pak kilometra nga krye-

qyteti, Monte Smith, me mbetjet mahnitëse të Tempullit të Apollonit.

Deti transparent i Lindos – Pesëdhjetë kilometra nga Rodosi është Lindos i bukur, një fshat i vogël me shtëpi të bardha dhe rrugë të ngushta, i mbushur me bare dhe restorante të vogla dhe komode që ofrojnë kuzhinën e shijshme të ishullit. Në Lindos, përveç Akropolit që e dominon nga një shkëmb, ngrihet një kështjellë me eshtrat e kalasë së fortifikuar të Kalorësve të Rodosit, ndërtuar në të njëjtin vend ku dikur qëndronte një akropolis



dhe një shenjtërore dedikuar Atenës. Plazhi i Lindos konsiderohet ndër më të bukurit në të gjithë Greqinë, sidomos për detin transparent.

Plazhi i ‘Zorbës greke’ – Për sa u përket plazheve, bregu lindor karakterizohet nga plazhe ranore dhe më pak të frekuentuara nga turistët. Ndërsa plazhet perëndimore janë me zhavorr: në mesin e tyre edhe Afandou, plazh i pajisur mirë me rërë dhe guralecë ose Agati piktoresk. Aktori i madh Anthony Quinn (Zorba grek) e donte mbi të gjitha një gjë të mrekullueshme që mori emrin prej tij: konsiderohet si një nga plazhet më të bukura të Rodosit, ky liman i vogël me rërë, me gurë të sheshtë ideal për të marrë reze, ajo derdhet në një det të gjelbër smeraldi që sfondi i rërës dhe shkëmbinjve e bën atë ideal për ‘snorkeling’.

Prasonissi, ideal për surfing – Mos harroni Prasonissin e bukur, ideal për adhuruesit e surfing dhe që shtrihet në majën jugore të Rodosit; përballë plazhit të artë me rërë, era dhe valët janë ideale për ata që duan rrëshqitje në ajër. Dhe pastaj Fourni i egër, ose Tsampika mikpritëse me rërë të hollë të artë, e cila është 800 metra e gjatë dhe rrjedh në një ujë të cekët kristalor bruz që e bën atë ideal për fëmijët. Por është edhe Kalithea, pranë Rodosit, e rrethuar me gjelbërim midis pishave dhe palmave, gjithashtu i njohur për banjot e ndërtuara nga italianët në fillim të shekullit të njëzetë dhe restauruar në vitet e fundit.

Kuzhina – Vakti tipik fillon me Mezedes, e bërë nga sallata greke, peshk i skuqur Tzatziki dhe qofte të shijshme (keftedakia). Gjithashtu duhet të provohet Pitaroudia, Soupiorizo, rizoto me kallamar të shijshëm Skorthopsomo, bukë hudhre dhe vaj ulliri. Ose Meliasti, djathi Feta i mbështjellë me makarona të mbushura me mjaltë dhe susam. Të shijshmet Chtapodi Xithato, oktapod i stilit grek dhe Psarosoupa, supë peshku dhe patate. (gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SPAIN - TUNISIA

1

FINLAND - BELARUS

1

FRANCE - USA

1

Kosova, me 13 gjimnastë në Maqedoni

Pas garës në Itali, ku Kosova u përfaqësua me katër gjimnaste, gara e radhës është sot (e shtunë) në Maqedoni. Tetë gjimnaste dhe pesë gjimnastë do ta përfaqësojnë Kosovën në këtë garë ndërkombëtare



PRISHTINË, 8 QERSHOR (ER) - Federata e Gjimnastikës e Kosovës (FGJK) vazhdon me paraqitjen e radhës me përfaqësim ndërkombëtar, këtë herë në Maqedoni. Në kuadër të kampionatit shtetëror të Maqedonisë në Gjimnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj, i cili do të mbahet në sallën e "KGS PARTIZAN" në Manastir (Bitola) në Maqedoni, më 9 qershor, për herë të parë që nga pavarësia e Maqedonisë dhe me kërkesë të Federatës Evropiane të Gjimnastikës (UEG), do të mbahen garat e para, në mes të reprezentacionit të Maqedonisë dhe të Kosovës, në

Gjimnastikë, jashtë konkurrence. Maqedonia është nikoqirja e pilotprojektit të parë të tillë që "FGSRM" e ka pranuar dhe në të ardhmen ky program (garë) do të zgjerohet edhe me pjesëmarrjen e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Bosnje e Hercegovinës, me qëllim të forcimit dhe zhvillimit të gjimnastikës në rajon. Federata do të përfaqësohet nga Elfet Gashi, nënkryetare e FGJK-së, kurse trajner për Gjimnastikë Artistike për Femra është caktuar Sherife Aliçkaj-Qerimi, kurse për Gjimnastikë Artistike për Meshkuj janë caktuar: Jetish Hetemi dhe Besnik Latifi.

KOSOVA DO TË PËRFAQËSOHET NGA KËTO/A GJIMNASTE/GJIMNASTË

- | | |
|---------------------|---|
| FEMRA | MESHKUIJ |
| 1. Drinesa Qerimi | 1. Taulant Ramadani |
| 2. Yvesa Islami | 2. Redon Qërimi |
| 3. Elena Manxholli | 3. Elion Viti |
| 4. Lonisa Reka | 4. Dion Mahmutaj |
| 5. Eljesa Kaçiu | 5. Ardi Halili |
| 6. Lisa Zeqiri | EKIPI I GJIMNASTEVE - (WOMAN TEAM) |
| 7. Rizione Mustafa | 1. Elena Manxholli |
| 8. Donika Kryemadhi | 2. Rizione Mustafa |
| | 3. Eljesa Kaçiu |
| | 4. Lonisa Reka |

SHKURT

Drita përforcohet me portierin Bakaj

Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka realizuar edhe transferimin e tretë në këtë afat kalimtar. Pas Betim Haxhimusës dhe Arbër Shalës, Drita transferoi sot portierin Edvan Bakaj. Portieri shqiptar që edicionin e fundit ishte pjesë e Lirisë nga Prizreni me Dritën ka nënshkruar kontratë njëvjeçare, kurse në të kaluarën ishte pjesë edhe e Tiranës, Laçit dhe Besës së Kavajës.

Brahimi: Humbja e Donjeta Sadikut, e padrejtë

Prishtinë, 8 qershor - Trajneri Besim Brahimi ka thënë se boksierja Donjeta Sadiku është mposhtur pa meritë në Kampionatin Evropian në Bullgari. "Donjeta humbi nga reprezentuesja polake me ndihmën e gjyqtarës, e cila e dëmtoi Donjetën me qortim publik. Ndërsa kundërshtaren nuk e qortoi, por ia tërhoqi vërejtjen shtatë herë. Përndryshe, ndeshja ishte e barabartë dhe për një nuancë të vogël përparësi kishte Donjeta, por ai qortim ia humbi një pikë. Duhet ta harrojmë sa më shpejt këtë humbje", ka thënë Brahimi.

Parma interesohet për Hetemajn

Mesfushori shqiptar Përparim Hetemaj mund të bëhet me skuadër të re. Ai ka mbetur futbollist i lirë, pasi kontrata me Chievon i ka skaduar me përfundim të kampionatit 20/17/2018 në Serinë A. Klubi italian i ka ofruar kontratë të re Hetemajt, por mesfushori ende nuk ka dhënë një përgjigje nëse do të vazhdojë me Chievon. Së fundmi, në garë për mesfushorin nga Kosova është futur skuadra e madhe italiane, Parma. Hetemaj ka luajtur edhe për skuadra të tjera si Helsinki, Twente, AEK dhe Brescia.

Sokoli, trajner i Llapit

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Bylbyl Sokoli edhe zyrtarisht është trajneri i ri i Llapit. Skuadra nga Besiana e ka prezantuar të premten "Profën" në krye të shtabit teknik për edicionin 2018/2019, kurse po të njëjtën ditë është zyrtarizuar edhe transferimi i Gent Musës nga Shkolla e Futbollit "Kurda". Dy përforcimet e tjera

që i realizoi Llapi janë Arbnor Ramadani dhe Ardian Hoti. Ramadani luan në pozitën e mesfushorit dhe ka arritur marrëveshje dyvjeçare me klubin, kurse sezonin e fundit regjistroi 14 paraqitje për Dritën. Ndërsa transferimi tjetër, Ardian Hoti, së fundmi ishte pjesë e KEK-ut. Hoti ka nënshkruar kontratë

trevjeçare me skuadrën nga "Zahir Pajaziti". Skuadra e Llapit po synon të dalë fituese në kampionat dhe garën e Kupës, prandaj ka bërë shumë ndryshime, në mesin e tyre më të rëndësishmet janë emërimi i Tahir Batatinës në postin e drejtorit sportiv dhe ai i Bylbyl Sokolit në postin e trajnerit.



11 futbollistë vazhdojnë me Vëllaznimit, por emrat mbahen sekretë

Gjakovë, 8 qershor - Skuadra e Vëllaznimit nëpërmjet një njoftimi ka bërë me dije se ka nënshkruar kontratë me 11 futbollistë, por nuk ka publikuar emrat e tyre. "Vëllaznimi të premten nën-

shkroi kontratë me 11 prej futbollistëve që janë në mesin e atyre që e kanë bartur barrën kryesore në kampionatin e porsapërfunduar. Kryesia e Klubit është në bisedime edhe me 3-4 të tjerë që, po ashtu, e

kanë bartur fanellën e Vëllaznimit në kampionatin e porsapërfunduar, ndërsa njëkohësisht është në bisedime edhe me 4-5 futbollistë të tjerë të cilët mëton t'i angazhojë si përforsime.

Bisedimet po vazhdojnë me trajnerin e njohur Gani Sejdiu dhe janë gjasat reale që të arrihet marrëveshja që ai t'i prijë Vëllaznimit në edicionin e ardhshëm të garave", thuhet në njoftimin e KF Vëllaznimit.



Boksierët filluan përgatitjet për 'Tarragona 2018'

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kanë mbetur edhe 14 ditë deri në fillimin e Lojërave Mesdhetare "Tarragona 2018", në të cilat Kosova do të marrë pjesë për herë të parë. 40 sportistë të 12 sporteve të ndryshme do ta përfaqësojnë Kosovën nga 22 qershori deri më 1 korrik 2018. Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik i Kosovës muajin e kaluar ka marrë vendim që të gjithë sportistët t'i dërgojë në përgatitje ndarazi. Në marrëveshje me Federatën e Boksit të Kosovës, ekipi i boksit është duke u përgatitur prej disa ditësh në Shkodër të Shqipërisë.

Besfort Merlaku, Dielli Vranoci, Patriot Behrami, Violant Sylejmani, do të synojnë medalje në "Tarragona 2018". Ata po përgatiten me përzgjedhësin e Kombëtares, Shefki Bogujevci. "Prej disa ditësh jemi duke u përgatitur në Shkodër bashkërisht me Kombëtaren e Shqipërisë, ku do të zhvillojmë përgatitje deri më 21 qershor. Jemi optimist se nuk do të kthehemi pa medalje nga Tarragona, por së pari urojmë të kemi edhe fat në short", ka deklaruar boksieri Violant Sylejmani. Në ditët në vijim edhe sportistët e



federatave të tjera do të udhëtojnë për në përgatitje.

Katër gjyqtarë nga Kosova, pjesë e "Tarragona 2018"

Listës së gjerë të sportistëve dhe trajnerëve të Kosovës për në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" i janë shtuar edhe katër gjyqtarë me licencë ndërkombëtare. Pas ftesës së ardhur nga organizatori i këtyre lojërave, KOK-u, në bashkëpunim

me federatat, bazuar edhe në numrin e sportistëve të tyre pjesëmarrës, ka vendosur t'i dërgojë gjyqtarët: Latif Demolli (boks), Valon Nikçi (volejboll në rërë), Ardian Muhadri (karate) dhe Abedin Bahtiri (pingpong). Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" mbahen në Tarragona të Spanjës, prej 22 qershor deri më 1 korrik 2018. Krahas gjyqtarëve, Kosovën e përfaqësojnë edhe 40 sportistë të 12 sporteve të ndryshme dhe 13 trajnerë.

Fituesit e Botërorit marrin plot 33 milionë euro nga FIFA

MOSKË, 8 QERSHOR - Kampionati Botëror i Futbollit është kompeticioni që u siguron të ardhura të mëdha federatave të skuadrave pjesëmarrëse, e ai i Rusisë nuk bën përjashtim. Tashmë është përcaktuar edhe shpërndarja e shpërblimeve për skuadrat pjesëmarrëse. Mësohet se skuadra triumfuese e Botërorit do të përfitojë 33 milionë euro, ndërsa ajo finaliste do të marrë 25 milionë euro. Skuadra e vendit të tretë do të sigurojë 21 milionë euro, kurse ajo e vendit të katërt 19 milionë euro. Ekipet që do të eliminohen në çerekfinale do të përfitojnë 15 milionë euro, kundrejt 11 milionëve të atyre të eliminuara në 1/8-at e finaleve. Shpërblim do të jepet edhe për klubet që lejuan futbollistët të marrin pjesë në kompeticion, e shifra totale do të jetë prej 177 milionë eurosh. Gjithashtu, klubet do të marrin në formën e dëmshtëpërblimit edhe 113 milionë euro të tjera, në rast se futbollistët e tyre do



të pësojnë dëmtime gjatë Kupës së Botës. Në të njëjtën kohë, edhe vetë federatat kanë përcaktuar shpërblimet për futbollistët e përfaqësuesve të tyre respektive. Kështu, te Spanja, që është një prej pretendentëve, lojtarët do të përfitojnë 825 mijë euro secili. Shumë pranë saj

është Brazili, me një shpërblim të akorduar prej 800 mijë eurosh për çdo lojtar. Shumë më e ulët është shifra e akorduar për Gjermaninë. Futbollistët e kësaj skuadre do të përfitojnë 350 mijë euro secili, nëse ia dalin mbanë ta mbrojnë titullin e fituar në vitin 2014.

SHKURT

"Marca": Perez është gati ta shesë Ronaldo

Real Madridi dhe Cristiano Ronaldo duket gjithnjë e më larg që prej finales së Kievit ku Reali siguroi Ligën e Kampionëve për të tretin vit radhazi. Tashmë është radha e "Marca"-s që shkruan se presidenti Perez është gati ta shesë yllin portugez. Madje spanjolle shkojnë edhe më tej, duke folur për një konfrontim të ndezur mes lojtarit dhe Florentino Perezit. Tashmë divorci duket i pashmangshëm duke marrë parasysh edhe kërkesën e lartë ekonomike të Ronaldos dhe ofertës së Realit. Reali është gati t'i japë lamtumirën portugezitet dhe Neymari duket gati për ta zëvendësuar atë. Një dorë duket se po ia jep edhe Marcelos, i cili ka folur së fundmi duke e ftuar yllin e PSG-së në Madrid, ndërsa është shprehur se herët a vonë ai do të jetë pjesë e Realit.

Leicesteri prezanton Evansin

Leicester City ka nënshkruar me mbrojtësin e West Brom Albionit, Jonny Evans. 30-vjeçari ka nënshkruar kontratë trevjeçare, kurse trajneri Claude Puel e ka mirëpritur transferimin e tij. "Jonny është një lojtar i një përvoje të shkëlqyeshme në Premierë Ligë dhe transferimi i tij është një lajm fantastik. Kjo është marrëveshje e madhe për skuadrën tonë", ka thënë ai. Ish-lojtari i Manchester United gjatë verës ishte kërkuar nga Leicester City, Arsenali dhe Manchester City.

Lëndohet Lanzini, humbet Botërorin

Pas portierit Sergio Romero, Argjentina humbet edhe një futbollist të rëndësishëm për Kampionatin Botëror 2018. Manuel Lanzini ka pësuar lëndim të rëndë në ligamentin kryesor të gjurit në këmbën e djathtë. Federata e Futbollit të Argjentinës ka konfirmuar se Lanzini do të mungojë në "Botërorin 2018".

Costa përfundimisht lojtar i Juventusit

Kampioni i Italisë, Juventus, e ka konfirmuar të premten blerjen përfundimtare të Douglas Costas nga Bayern Munchen. Sulmuesi brazilian iu bashkua Juventusit verën e 2017-s, me formulën e huazimit nga Bayerni dhe me të drejtë blerjeje, për shumën e 40 milionë eurove. Tash "Zonja e Vjetër" është pajtuar për ta blerë përfundimisht kartonin e Costas dhe ai edhe edicionin e ardhshëm do t'i mbrojë ngjyrat bardh e zi.

LeBron: Golden State, shumë më i fortë se vjet

Disavantazhi 0-3 me ndeshje duket se i ka humbur çdo shpresë skuadrës së Cleveland Cavaliersit për ta fituar titullin kampion këtë sezon në NBA. Kampionët në fuqi të Golden State Warriorsit janë një fitore larg titullit, që mund të vijë shumë shpejt. Edhe sfida e katërt finale e "play-off"-it do të luhet në fushën e Cavaliersit, që shpresojnë ta korin fitoren e parë në këtë seri takimesh dhe mbajnë gjallë shpresat, edhe pse për LeBron Jamesin kjo do të jetë vetëm shtyrje e agonisë. "Është e qartë që Golden State është një ekip më i kompletuar sesa i yni. Kjo është e vërteta. Kanë në formacionin bazë lojtarë MVP, Durant dhe Curry, ndërsa pas tyre është Klay Thompson apo edhe Draymond, mbrojtësi më i mirë dhe mjaft të tjerë që janë në stol, që bëjnë diferencën në çdo moment. Për mua, ekipi i Warriorsit është më i fortë se vjet", u shpreh LeBron James. "Kemi pasur një sezon me luhatje, kemi bërë shumë gabime dhe ky sezon ka qenë sa 4 së bashku për mua. Duhej të bënim më pak gabime në fushë dhe jashtë saj, të luanim në një mënyrë më inteligjente. Megjithatë, do ta bëjmë maksimumin në këtë sfidë të fundit, për sa kohë mrekullitë ekzistojnë do të tentojmë ta realizojmë atë. Duhet të fitojmë për fansat tanë, që na kanë mbështetur shumë", ka deklaruar Jamesi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteti i Bolnicka I Klinicka Sluzba Kosova
Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpi për Integrim në Bashkësi-Ferizaj

Nr.p 194/2018

SHPSHM në Ferizaj, në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 e të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; Ncni 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; nenit 5, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003/2016; në bazë të Kërkesës së aprovuar nga Drejtori i SHSKUK-së nr 183/2018 të datës 17.05.2018 publikon:

KONKURS PUBLIK

Titulli i vendit të punës	QSHMSHIB në Ferizaj	Nr. pozitave të lira pune
1. Zyrtar Administrativ	Buxhet dhe Financa	Një (1)
2. Teknik Fizioterapeut	QSHMSHIB	Një (1)

Institucioni: QSHMSHIB në Ferizaj
Norma e punës: Orari i plotë,
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Titulli i vendit të punës: Zyrtar Administrativ dhe Teknik Fizioterapeut
I Raporton: Udhëheqësit të drejtpërdrejtë,
Kategoria funksionale/Grada: Nr. 1- 5.4, Nr. 2- 5.4

Titulli i punës: Zyrtar Administrativ për Buxhet dhe Financa, me numrin rendor 1
Qëllimi kryesor i vendit të punës

- Zbatimi dhe respektimi i ligjëshmërisë

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Pranimit i kërkesave për zotim
- Zbatimi dhe respektimi i ligjëshmërisë
- Percjellja e disponueshmërisë së mjeteve
- Përgjithësimi e zotimeve
- Evidentimi dhe regjistrimi i zotimeve
- Respektimi dhe bashkëpunimi i hierarkisë

Njohuria, shkathhtësitë, aftësitë dhe kualifikimi kërkuar:

- Të njohë punën me kompjuter (e nevojshme).
- Aftësi për të punuar pa mbikëqyrje,
- Te ketë aftësi komunikuese,
- Të jetë i motivuar për punë.

Titulli i punës: Teknik Fizioterapeut, me numrin rendor 2

Qëllimi kryesor i vendit të punës

- Ofron dhe udhëheq shërbimet e fizioterapis ndaj Klientëve në QSHMSHIB

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Ofron dhe udhëheq shërbimet e fizioterapis ndaj Klientëve në QSHMSHIB
 - Obligimet dhe përgjegjësitë e punës duke qenë pjesë e ekipit infermierik
 - Ofron shërbimet fizioterapeutike me kliente të QSHMSHIB -Ferizaj
 - Jep këshilla dhe ushëzime për program shtëpiak për mirmbajtjen dhe rritjen e rrezultateve të arritura
 - Zhvillon planin e trajtimit
 - Merr përgjegjësin për aftësimin të vazhdueshëm profesional
- Njohuria, shkathhtësitë, aftësitë dhe kualifikimi i kërkuar:**
- Aftësi për të punuar pa mbikëqyrje,
 - Te ketë aftësi komunikuese,
 - Të jetë i motivuar për punë.

Shkollimi, Përgatitja profesionale:

Kandidatet nën numër 1 të kenë të kryer shkollën e mesme të ekonomisë, gjimnazet
Kandidati/ja nën numër 2 të ketë të kryer shkollën e mesme të mjeksisë –drejtimit Teknik Fizioterapeut

Dokumentet e nevojshme:

Kandidatet nën numër 1. diplomën e shkollës së mesme dhe kopjen e letërnjoftimit, ata me nr. rendor 2 të jenë të licencuar për profesionin . diplomën e shkollës së mesme dhe kopjen e letërnjoftimit,

Procedurat e konkurrimit :

Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet dhe kriteret për këtë konkurs.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin e punës Nr.03/L-212 dhe legjislacionit në fuqi, për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendariq nga data e publikimit (shpalljes).

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Administratës në QSHMSHIB në Ferizaj

Drejtori i QSHMSHIB në -Ferizaj
Dr Bahri Goga

Datë:07.06.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteti i Bolnicka I Klinicka Sluzba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Centar za mentalno zdravlje sa integracijom u zajednicu Kuca-Uroševac

Nr.p_194/2018_

SHPSHM u Uroševcu, u skladu sa članom 8. tačka 1 i 2 Zakona o radu br. 03 / I-212; Član 4 Administrativnog uputstva (MRSZ) br ; Član 5, stavovi 1 i 2 Pravilnika o radnim odnosima br. 1003/2016; na osnovu zahteva odobrenog od strane Direktora SHSKUK-a br. 183/2018 od 17.05.2018, objavljuje:

JAVNI KONKURS

Naziv radnog mjesta:	CSMSHIB u Uroševcu	br. slobodno radno mesto
1. Administrativni službenik za budžet i finansije		Jedan (1)
2. Tehnički Fizioterapeut	KSHMSHIB	Jedan (1)

Institucija: CSSSHIB u Uroševcu
Radna stopa: Puni raspored,
Ugovor: P
Naziv posla: Administrativni službenik i Tehnički fizioterapeut
I Izvčštaji: Direktni lider,
Funkcionalna kategorija / Grad Br. 1- 5.4, br. 2- 5.4

Naziv posla: Administrativni službenik za budžet i Financije, sa rednim brojem 1

Glavni cilj posla

- Izvršenje i poštovanje zakonitosti

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Izvršenje i poštovanje zakonitosti
- Prati dostupnost alata
- Priprema obaveza
- Snimanje i evidentiranje obaveza
- Poštovanje i saradnja hijerarhije

Potrebno znanje, veštine, veštine i kvalifikacije:

- Prepoznati rad računara (potrebno).
- Sposobnost rada bez nadzora,
- Imaju komunikacijske veštine,
- Budite motivisani za rad.

Naziv posla: Fizioterapeut, sa rednim brojem 2

Glavni cilj posla:

- Pruža i pruža usluge fizioterapije Klientima na MSSSHIB-u
- Glavne dužnosti i odgovornosti:**

- Pruža i pruža usluge fizioterapije klientima u CSSSHIB-u
- Obaveze i odgovornosti rada koji su deo seestrinskog tima
- Pruža fizioterapeutske usluge sa klientima CSMSHIB -Ferizaj
- Obzbediti savet i uvid u domaći program za održavanje i povećanje postignutih rezultata
- Razvija plan tretmana
- preuzima odgovornost za nastavak stručnog usavršavanja

Potrebno znanje, veštine, veštine i kvalifikacije:

- Sposobnost rada bez nadzora,
- Imaju komunikacijske veštine,
- Budite motivisani za rad.

Obrazovanje, stručna priprema:

Kandidati pod brojem 1 imaju završenu srednju ekonomsku školu, gimnaziju
Kandidat pod brojem 2 mora imati završenu srednju školu. u lekaru - tehnički fizioterapeut

Potrebni dokumenti:

Kandidati pod brojem 1. Diploma srednje škole i kopija lične karte, oni sa ne. naredba 2 da bude licencirana za ovu profesiju, diploma srednje škole i kopija lične karte,

Takmičarski postupci:

Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate koji ispunjavaju uslove i kriterijume za takmičenje.

Zakonodavni i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje: Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212 i važećim zakonima, kojim se uređuju procedure uspostavljanja radnog odnosa u javnom sektoru.

Datum zatvaranja takmičenja: Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja.
Podnošenje prijave: Prijave primaju se i dostavljaju Administrativnoj službi u CSMSHIB u Uroševcu

Datum: 07.06.2018

Direktor CSSSHIB-a u Uroševcu
Dr. Bahri Goga

Në numrin e gazetës së shkruar të datës 8 qershor 2018 (e premte) është publikuar një konkurs nga Qendra e Shëndetit mendor me Shtëpi për Integrim në Bashkësi - Ferizaj, me rast është përvjedhur një gabim teknik dhe është botuar pa dashje një konkurs tjetër. Kërkojmë mirëkuptimin e lexuesve, të kandidatëve të cilët dëshirojnë të aplikojnë në këto pozita si dhe QSHMSHIB të Ferizajt. Konkursi që është dashur të botohet mbanë numrin e protokollit: N.P: 194\2018, dhe i cili botohet sot ditë e shtunë 09.06.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Këshilli i Sigurisë i Kosovës
Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council
Sekretariati / Sekretariat / Secretariat

NJOFTIM

ANULOHET konkursi për pozitën **Zyrtar i Lartë për përkthim (shqip-serbisht)**, SKSK-011 në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës sipas konkursit të shpallur me datë 22 maj 2018, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të aplikacioneve të pranuar. Anulimi bëhet duke u bazuar në nenin 22 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

O B A V E Š T E N J E

PONIŠTAVA se konkurs za poziciju Viši službenik za prevođenje (albanski-srpskog), SSBK-011 Sekretariat Saveta Bezbedosti Kosovo, prema konkursu objavljenom 22 maja 2018, zbog nedovoljnog broja prijavljenih aplikacija, Poništava. Konkurs se poništava na osnovnu clana 22 stav 4 Uredbe 02/2010 o proceduri rekrutiranja u civilnoj službi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta -Ministry of Culture, Youth & Sports

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

05.06.2018

NJOFTIM PËR ZGJATJEN E PRANIMIT TË APLIKACIONEVE

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton se për të arritur pranimin e balancuar të aplikacioneve nga aspekti gjinor dhe etnik zgjat edhe për 7 ditë kalendrike pranimin e aplikacioneve për pozitën:

Drejtor në AKKV "Shota"

O B A V E Š T E N J E O P R O D U Ž E N J U P R I M A N J A A P L I K A C I J A

Ministarstvo Kulture Omladine i Sporta oslanjajući se o proceduri primanja, obaveštava vas da u cilju dostizanja za balansni prijem aplikacija sa polnog i etničkog aspekta , nastavlja se za još 7 kalendarskih dana primanje aplikacija za sledeću poziciju:

Direktor u NAPI "Shota"

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



Republika e Kosovës

Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agjencia za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture
Development Agency

Divizioni për Komunikim me Publikun – Divizia za Javno Komuniciranje
Division of Public Communication

Njoftim për fermerë

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural njofton të gjithë fermerët e interesuar se afati për aplikim për Programin e Veçantë për Zonat më pak të Zhvilluara do të zgjatet siç vijon:

Afati për aplikim për Masën “Ngritja e aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë, pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së Veriut” **zgjatet deri me datë 22 qershor 2018, ora 16:00**. Ndërsa, afati për aplikim për Masën “Investimet në infrastrukturën rurale” **zgjatet deri me datë 18 qershor 2018, ora 16:00**.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në të gjitha zyrat regjionale, në Zyrën e Arkivës në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë, si dhe Zyrën e Arkivës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ndërtesa e Ish Partive Politike në Prishtinë, nr. 242 kati II zona C. Ndërsa, për masën “Ngritja e aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë, pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së Veriut” aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyrën Regjionale në veri ose jug të Mitrovicës.

Vëmendje: Aplikacionet duhet të dorëzohen me zarfin e sigurisë të cilin ua sigurojnë zyrtarët e MBPZHR-së!



Republika e Kosovës

Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agjencia za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture
Development Agency

Divizioni për Komunikim me Publikun – Divizia za Javno Komuniciranje
Division of Public Communication

Obaveštenje za farmere

Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja obaveštava sve farmere interesovanih da će rok za aplikaciju za Posebni Program za manje razvijene Zone biti produžen kako sledi: Rok za apliciranje za Meru "Podizanje konkurentnosti u sektoru poljoprivrede i šumarstva kroz uključivanje zajednice u ruralni razvoj u regiji Severna Mitrovica" produžen je do 22. juna 2018. godine do 16:00 sati. Međutim, rok za aplikaciju za Meru "Investicije u seosku infrastrukturu" produžen je do 18. juna 2018. godine, do 16:00 sati.

Prijave se moraju predati u svim regionalnim kancelarijama, u Kancelariji arhiva u Agenciji za Razvoj Poljoprivrede u Prištini, kao i Kancelariji za arhivu pri Ministarstvu Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja, bivša zgrada političkih stranaka u Prištini, br. 242 sprat II zona C. Odnosno za meru "Podizanje konkurentnosti u sektoru poljoprivrede i šumarstva kroz uključivanje zajednice u ruralni razvoj u regionu Severne Mitrovice", aplikacije treba da se predaju u Regionalnoj Kancelariji na severu ili jugu Mitrovice.

Pažnja: Aplikacije moraju biti predate sa sigurnosnom kovertom koju osiguravaju zvaničnici MPŠRR-ja!

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Dr. Albulenë Retkoceri- Bujupi, shpallë të pavlefshme licencën e punës me nr. KO-05137-02. Nr. personal: 1500993606.

► Burhan Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Hajrullah Tanushaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Emin Duraku" Prizren.

► Feride Goran shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Ardiana Hoti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Motrat Qiriazit" Prizren.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjëm me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333